Icko Gjorgoski Metodija Najdovski Biljana Giçevski

SHKENCAT NATYRORE

5

TEKST MËSIMOR PËR KLASËN 5 NË ARSIMIN FILLOR NËNTËVJEÇAR

SHKENCAT NATYRORE

për klasën 5 në arsimin fillor nëntëvjeçar

Shkup, 2022

Shkencat natyrore për klasën 5 në arsimin fillor nëntëvjeçar

Autorë
Icko Gjorgoski
Metodija Najdovski
Biljana Giçevski

Recensentë
Lenka Cvetanovska
Liljana Mirçeva
Marija Petrovska

Botues:
Ministria e Arsimit dhe Shkencës e Republikës së Maqedonisë së Veriut
Rr. "Shën Kirili dhe Metodi" nr. 54, 1000 Shkup

Titulli origjinal:
Природни науки за 5 одделение во деветгодишното основно образование
Ицко Ѓоргоски
Методија Најдовски
Билјана Гичевски

Redaktor
Refail Sulejmani

Përkthyer nga gjuha maqedonase
Refail Sulejmani

Redaktor profesional i botimit në gjuhën shqipe
Neshe Salih

Lektor
Refail Sulejmani

Redaktimi grafik dhe teknik
Leon Xhingo, Evgenija Pavllova - ARS STUDIO

Vendi dhe viti i botimit: Shkup, 2022

Me vendim për miratimin e tekstit mësimor në lëndën e shkencave të natyrës për klasën 5 nr. 26-213/1 të datës 15.08.2022 i miratuar nga Komisioni kombëtar i teksteve mësimore.

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

373.3.016:5(075.2)=18

GJORGOSKI, Icko
Shkencat natyrore për klasën 5në arsimin fillor nëntëvjeçar : Електронски извор / [autorë Icko Gjorgoski, Metodija Najdovski, Biljana Giçevski ; përkthyer nga gjuha maqedonase Refail Sulejmani]. - Shkup : Ministria e arsimit dhe shkencës e Republikës së Maqedonisë së Veriut, 2022

Начин на пристапување (URL):
https://e-ucebnici.mon.gov.mk/pdf/Prirodni_nauki_5_alb.pdf. - Превод на делото: Природни науки за 5 одделение во деветгодишното основно образование / Ицко Ѓоргоски, Методија Најдовски, Билјана Гичевски. - Текст во PDF формат, содржи 145 стр., илустр. - Наслов преземен од екранот. - Опис на изворот на ден 01.12.2022

ISBN 978-608-273-212-1

1. Najdovski, Metodija [автор] 2. Giçevski, Biljana [автор]

COBISS.MK-ID 58924293

PARATHËNIE

Teksti mësimor SHKENCAT NATYRORE për klasën e pestë është shkruar në përputhje me programin mësimor të planifikuar për këtë lëndë.

Materiali mësimor është i ndarë në pesë tema:

1. **Karakteristikat natyrore-gjeografike të kontinenteve**
2. **Cikli jetësor i bimëve të lulëzuara**
3. **Organizmat e gjallë dhe mjedisi jetësor**
4. **Përzierjet**
5. **Drita dhe hijet**

Tema e **parë** përshkruan veçoritë natyrore të kontinenteve. Shpjegohet pozita gjeografike, relievi, klima dhe ujërat e të gjitha kontinenteve. Leximi i hartës është pjesë e njohurive që do të përfitohen.

Tema e **dytë** fillon duke përshkruar strukturën e luleve dhe duke shpjeguar proceset e polenizimit, polenizimit, prodhimit, shpërndarjes dhe mbirjes të farës, si pjesë e ciklit jetësor në bimë. Kjo temë përshkruan ndryshimet midis cikleve të jetës dhe jep shembuj për të treguar se bimët e reja u ngjajnë prindërve.

Përshkrimi i llojeve të vendbanimeve, si dhe llojet e ndryshme të përshtatjeve sipas strukturës dhe sjelljes së disa kafshëve dhe bimëve, janë vendosur në temën e **tretë**. Në atë gjithashtu përmenden ndikimet negative të njeriut ndaj mjedisit jetësor dhe aktivitetet e njeriut për të mbrojtur mjedisin jetësor. Në këtë temë thuhet se ekologjia është shkenca e marrëdhënieve të ndërsjella ndërmjet organizmave të gjallë dhe mjedisit jetësor.

Në tema e **katërt** përshkruhen përzierjet, përbërjen dhe ndryshimet midis tyre. Shpjegohen tretësirat, si dhe ndikimi i temperaturës, përzierjes dhe madhësisë së grimcave të substancës së tretur në shpërbërjen e substancave të ngurta në ujë. Kjo pjesë gjithashtu përshkruan procedurat për ndarjen e përbërësve nga përzierja.

Tema e fundit, e **pesta**, shpjegon se çfarë është drita, ngjyrat dhe si formohen hijet. Duke bërë këtë, renditen burimet natyrore dhe artificiale të dritës dhe përshkruhet edhe mënyra se si i shohim gjërat. Në fund të kësaj teme shpjegohen arsyet e shfaqjes së hijeve dhe shpjegohet arsyeja e madhësisë së hijes dhe zbatimi i tyre në jetën e përditshme.

Qasja e shpjegimit të materialit është e thjeshtë me një numër të madh shembujsh dhe aktivitetesh të sugjeruara që çojnë në zhvillimin e të menduarit kritik ndaj dukurive përkatëse natyrore.

Në fund të çdo teme ka pyetje ose nxitje specifike për të menduar, si dhe mënyra për të kryer eksperimente të thjeshta, duke nxitur kështu aftësinë e nxënësit për të vëzhguar, regjistruar, analizuar dhe nxjerrë përfundime.

Teksti mësimor është ndihmesë për nxënësit dhe arsimtarët, në mënyrë që brezave të ardhshëm të nxënësve t'u ofrohet edukim më i mirë në fushën e shkencave natyrore.

Nga autorët

PËRMBAJTJA

TEMA 1: KARAKTERISTIKAT NA TYRORE-GJEOGRAFIKE TË KONTINENTEVE

1.1 Pozita gjeografike, kufijtë dhe madhësia e kontinenteve 8
1.2 Formimi i relievit nën veprimin e forcave të brendshme 11
1.3 Vullkanet dhe tërmetet 13
1.4 Formimi i relievit nën veprimin e forcave të jashtme 16
1.5 Llojet e relievit 18
1.6 Shkëmbinjtë 21
1.7 Përbërja dhe ndarja e atmosferës 23
1.8 Elementet meteorologjike 25
1.9 Dukuritë meteorologjike 27
1.10 Faktorët klimatikë dhe brezat termikë 29
1.11 Ndikimi i klimës në shpërndarjen gjeografike të jetës bimore dhe shtazore 32
1.12 Deti botëror dhe lëvizjet e ujit të detit 35
1.13 Ujëratnëntokësore dhe burimet 38
1.14 Lumenjtë dhe liqenet 40
Kontrollo sa ke mësuar 42

TEMA 2: CIKLI JETËSOR I BIMËVE TË LULËZUARA

2.1 Pse bimët kanë lule? 47
2.2 Pjesët e lules dhe roli i tyre 50
2.3 Polenizimi i bimëve 53
2.4 Hulumtimi i polenizimit 55
2.5 Çfarë është fekondimi në bimë? 57
2.6 Farat dhe frutat 59
2.7 Si përhapen farat 62
2.8 Metoda të tjera të shpërndarjes së farës 65
2.9 Si rriten farat? 67
2.10 Cikli jetësor i bimëve 69
Kontrollo sa ke mësuar 71

TEMA 3: ORGANIZMAT E GJALLË DHE MJEDISI JETËSOR

3.1 Mjedisi jetësor 74
3.2 Llojet e mjediseve jetësore dhe vendbanimeve 74
3.3 Përshtatja e organizmave të gjallë me kushtet
në mjedis 78
3.4 Ndikimi i njerëzve në mjedisin jetësor 82
3.5 Shqetësimi i njeriut për mjedisin jetësor 85
3.6 Ndikimi i ndotjes ndaj njerëzve,
kafshëve dhe bimëve 88
3.7 Lidhjet ndërmjet organizmave të gjallë dhe mjedisit jetësor 90
Kontrollo sa ke mësuar 93

TEMA 4: PËRZIERJET

4.1 Përbërja e përzierjeve 96
4.2 Llojet e përzierjeve 100
4.3 Tretjet dhe shpërbërja 102
4.4 Faktorët themelorë të cilët ndikojnë në tretjen e
substancave të ngurta në ujë 105
4.5 Ndarja e përbërësve nga përzierja:
sitja dhe dekantimi 109
4.6. Ndarja e përbërësve nga përzierja:
filtrimi, kristalizimi dhe ndarja magnetike 112
Kontrollo sa ke mësuar 116

TEMA 5: DRITA DHE HIJET

5.1 Drita 120
5.2 Ngjyrat e ylberit 124
5.3 Reflektimi i dritës 126
5.4 Ndryshimi i drejtimit dhe kahjes së
përhapjes së dritës 129
5.5 Pasqyra dhe periskopi 131
5.6 Aplikimi i pasqyrave 134
5.7 Hijet 136
5.8 Materialet e tejdukshme dhe të patejdukshme 138
5.9 Madhësia e hijes 140
5.10 Intensiteti i dritës 142
Kontrollo sa ke mësuar 144

TEMA 1: KARAKTERISTIKAT NATYRORE - GJEOGRAFIKE TË KONTIENTEVE

REZULTATET NGA MËSIMI:

Nxënësi/nxënësja do të jetë në gjendje:

1. Të përshkruajë pozitën gjeografike, kufijtë dhe madhësinë e kontinenteve dhe t'i tregojë ato në hartë;
2. Të shpjegojë forcat natyrore të brendshme dhe të jashtme që formojnë relievin dhe të përcaktojë llojet e relievit;
3. Të përshkruajë përbërjen e atmosferës, të bëjë dallimin ndërmjet elementeve meteorologjike dhe dukurive meteorologjike dhe të përshkruajë brezat termik dhe ndikimin e klimës në shpërndarjen e jetës bimore dhe shtazore;
4. Të dallojë dhe të lidhë termat det botëror, ujëra nëntokësore dhe sipërfaqësore dhe të shpjegojë kuptimin e karakteristikave natyrore-gjeografike për ekzistencën e jetës në planetin Tokë.

1.1 POZITA GJEOGRAFIKE, KUFIJTË DHE MADHËSIA E KONTINENTEVE

FJALË PËR TË MËSUAR:

kontinenti, oqeani, pozita gjeografike, ekuatori, meridiani i Griniçit, hemisfera veriore, hemisfera jugore, hemisfera lindore, hemisfera perëndimore, kufijtë, madhësia, Azia, Afrika, Amerika e Veriut, Amerika e Jugut, Antarktida, Evropa, Australia me Oqeania

Duke vëzhguar globin dhe hartën gjeografike, mund të vërehen vija të vizatuara horizontale dhe vertikale. Vijat horizontale quhen meridianë, kurse vijat vertikale quhen meridianë. Ato janë vija imagjinare.



Ekuatori dhe meridiani fillestar (i Griniçit)

Vijat tërthore ose paralele janë vija rrethore imagjinare. Në glob ato vizatohen si rrathë, kurse në hartë si vija paralele. Ekuatori përfaqëson vijën fillestare dhe më të gjatë, e cila është e barabartë e larguar nga Poli i Veriut dhe i Jugut. Ka vlerë prej 0°, e cila shkruhet në skajin e majtë dhe të djathtë të hartës. Ekuatori e ndan Tokën në hemisferën veriore dhe jugore. Të gjitha pikat që janë në veri të ekuatorit i përkasin hemisferës veriore, kurse ato që janë në jug të tij i përkasin hemisferës jugore.

Meridianët janë vija imagjinare gjysmërrethore që lidhin Polin Verior dhe Jugor të Tokës. Sipas marrëveshjes ndërkombëtare, si meridian fillestar konsiderohet ai që kalon nëpër Observatorin e Griniçit në Londër (Britania e Madhe). Ai ka vlerë prej 0°, e cila shënohet në skajet e sipërme dhe të poshtme të hartës. Meridiani fillestar e ndan Tokën në hemisferat lindore dhe perëndimore. Pikat e vendosura në lindje të meridianit fillestar i përkasin hemisferës lindore, ndërsa ato në perëndim janë në hemisferën perëndimore.

Për të përcaktuar pozitën gjeografike të ndonjë vendi, është e nevojshme të përcaktohet pozicioni i tij në raport me ekuatorin dhe meridianin fillestar.



hemisfera veriore *hemisfera jugore* *hemisfera perëndimore* *hemisfera lindore*

Tashmë e di se kontinent është sipërfaqe e madhe tokësore e rrethuar nga oqeane dhe dete. Në hemisferën veriore janë kontinentet e Evropës, Amerikës së Veriut dhe pjesë të Azisë, Afrikës dhe Amerikës së Jugut. Në hemisferën jugore janë kontinentet e Australisë me Oqeaninë, Antarktidën, si dhe pjesë të Amerikës së Jugut, Afrikës dhe Azisë. Hemisfera lindore përfshin kontinentet e Azisë, Australisë me Oqeaninë dhe pjesë të Evropës, Afrikës dhe Antarktidës. Hemisfera perëndimore përfshin Amerikën e Veriut, Amerikën e Jugut dhe pjesë të Afrikës, Evropës dhe Antarktidës.



Pozita gjeografike e kontinenteve

Azia - 44 milionë km^2
Afrika - 30 milionë km^2
Amerika e Veriut - 24 milion km^2
Amerika e Jugut - 18 milion km^2
Antarktida - 14 milion km^2
Evropa - 10 milion km^2
Australia me Oqeaninë - 9 milionë km^2

Madhësia e kontinenteve

A mund të përcaktosh vetë kufijtë e kontinenteve? Azia është kontinenti më i madh në Tokë, kufizohet me Oqeanin Arktik në veri, me Oqeanin Paqësor në lindje, me Oqeanin Indian në jug dhe me Evropën në perëndim.

Kontinenti i dytë më i madh, Afrika del në dy oqeane: Oqeanin Atlantik në perëndim dhe Oqeanin Indian në lindje. Kontinentet e Amerikës Veriore dhe Jugore në perëndim i stërpikin ujërat e Oqeanit Paqësor, kurse në lindje ato dalin në Oqeanin Atlantik. Amerika e Veriut del në Oqeanin Arktik në veri. Kontinenti i fundit i zbuluar, Antarktida, kufizohet me Oqeanin Jugor në veri. Kontinenti i Evropës shtrihet në Oqeanin Atlantik në perëndim, Oqeanin e Ngrirë të Veriut në veri dhe kontinentin e Azisë në lindje. Kontinenti më i vogël i Australisë me Oqeaninë në perëndim dhe jug hapet në Oqeanin Indian, kurse në veri dhe lindje me Oqeanin Paqësor.

AKTIVITET

Do të të duhet:
top ose tullumbace, stilolaps me majë, glob ose hartë gjeografike.

Merr një top ose tullumbace të fryrë. Me stilolaps shënoje ekuatorin dhe meridianin e Griniçit. Pastaj përpiqu t'i vizatosh kontinentet. Kushtoji vëmendje pozitës së kontinenteve në pamje e ekuatorit dhe meridianit fillestar! Krahasoje krijimin tënd me pozitën e kontinenteve në glob ose hartën gjeografike.

MENDO!

Në cilin kontinent ndodhet vendlindja jonë dhe cila është pozita e saj gjeografike?

Cila hemisferë ka më shumë sipërfaqe tokësore se sa sipërfaqe ujore?

PYETJE

1. Si përcaktohet pozita gjeografike e ndonjë vendi?

2. Cilat kontinente priten nga ekuatori dhe cilat nga meridiani fillestar?

ÇFARË KE MËSUAR

- Pozita gjeografike përcaktohet në lidhje me ekuatorin dhe meridianin fillestar.

1.2 FORMIMI I RELIEVIT NËN VEPRIMIN E FORCAVE TË BRENDSHME

FJALË PËR TË MËSUAR:

reliev, forca të brendshme, lëvizje tektonike, male, lugina

Sipërfaqja e tokës nuk është uniforme. Lartësitë, thellësirat dhe fushat ndryshojnë në kontinente dhe nën oqeane dhe dete. Kjo pamje e jashtme e Tokës quhet reliev.

Planeti Tokë u formua rreth 4.5 miliardë vjet më parë. Në fillim ishte trup i nxehtë i cili, duke lëshuar nxehtësinë e tij në hapësirën e ftohtë, gradualisht ftohej dhe kondensohej. Materiet më të lehta mbetën në sipërfaqe, kurse ato më të rëndat u fundosën drejt pjesëve qendrore të Tokës. Kjo zgjati për miliona vjet. Me kalimin e kohës u formua kore e hollë e fortë që u bë më e trashë. Në këtë mënyrë u formuan masat e para më të vjetra tokësore.

Sot mbulesa e fortë shkëmbore në sipërfaqen e Tokës quhet litosferë. A të kujtohet se ajo është më e hollë nën oqeane dhe më e trashë nën kontinente? Litosfera përbëhet nga pllaka të shumta që kanë madhësi dhe forma të ndryshme.



Litosfera përbëhet nga një numër i madh pllakash

Temperaturat e larta dhe presionet e larta që mbizotërojnë brenda Tokës bëjnë që masa e nxehtë në Tokë të jetë në lëvizje të vazhdueshme dhe bëjnë presion mbi pllakat e litosferës. Lëvizjet e pllakave njihen si lëvizje tektonike. Këto lëvizje shkaktojnë ndryshime të mëdha në reliev, si në tokë ashtu edhe në tokë nën oqeane dhe dete. Nën ndikimin e forcave të brendshme, disa pjesë të sipërfaqes së Tokës ngrihen dhe shndërrohen në male, kurse disa pjesë ulen dhe shndërrohen në lugina.

AKTIVITET

Aktiviteti 1

Do të të duhet: kompjuter me internet.

Kërko në internet se cili ishte orari në tokë në periudha të ndryshme të zhvillimit të planetit Tokë! Çfarë konkludon, se pjesët e tokës a janë të lëvizshme apo të palëvizshme? Cila është arsyeja e kësaj gjendjeje?

Aktiviteti 2

Do të të duhet: letër për pjekje, krem çokollatë, dy krikerë dhe gotë uji.

Formimi i malit

Si bazë vendos letrën për pjekje. Përsipër shtro një shtresë më të trashë kremi me çokollatë.
Ai përfaqëson masën e nxehtë brenda në tokë. Një kreker vendose në gotën me ujë që të zbutet dhe më pas e kalon te kremi me çokollatë. Vendose krekerin tjetër pranë tij. Dy krekerët përfaqësojnë dy pllaka të litosferës. Ushtro presion me gishtat në të dy krekerët dhe lëvizi ato drejt njëri-tjetrit. Çfarë ndodh me krekerin që është zbutur me ujë? Si të duket forma e ngritur? A mund ta marrësh me mend se cila formë e tokës është formuar në këtë mënyrë?

PYETJE

1. Shpjego si veprojnë forcat e brendshme në formimin e relievit!

ÇFARË KE MËSUAR

- Relievi është pamja e jashtme e Tokës.
- Forcat e brendshme veprojnë në formimin e formave të mëdha të relievit në Tokë.

MENDO!

Gjatë gjithë periudhës së gjatë kohore në të cilën u formua planeti Tokë, kontinentet a e kanë pasur pozitën e tyre të sotme apo ka ndryshuar? Mundohu të shpjegosh pse është kështu!

1.3 VULLKANET DHE TËRMETET

FJALË PËR TË MËSUAR:

vullkan, shpërthim, lavë, magmë, krater vullkanik, krater, kanal vullkanike, gejzer, tërmet, hipoqendër, epiqendër, cunam

Vullkanet dhe tërmetet janë dukuri natyrore. Janë forca të brendshme që veprojnë në formimin e relievit. Shpesh ndodhin në të njëjtat vise të planetit Tokë. Shumica e vullkaneve dhe tërmeteve janë në të ashtuquajturit "Brezi i zjarrit", i cili përfshin pjesët lindore të Azisë dhe pjesët perëndimore të kontinenteve të Amerikës së Veriut dhe Amerikës së Jugut. Gjithashtu ndodhin vullkane dhe tërmete në pjesët jugore të Evropës dhe në pjesët lindore të Afrikës. Mundohu të gjesh një vullkan në hartën gjeografike! Vullkanet dhe tërmetet e forta që shkaktojnë dëme materiale dhe vuajtje njerëzore janë fatkeqësi natyrore.

Viset e Tokës me vullkane



Elementet e vullkani

Vullkani është vend në sipërfaqen e Tokës ku llava, gazrat, hiri, tymi nxirren nga brendësia e Tokës.

Hapja e vullkanit quhet krater. Kanali vullkanik e lidh kraterin me shtratin e magmës. Rezervuari i magmës ndodhet në shtresat më të thella të litosferës dhe rrjedhimisht magma shkon kah sipërfaqja e Tokës.

Në rrugën e saj përmes kanalit vullkanik, magma, e cila është masë e shkrirë, i shkrin shkëmbinjtë që çojnë në krijimin e avujve të ujit dhe gazrave. Këto procese pasohen nga shpërthimet. Kur magma del në sipërfaqe të Tokës quhet lavë. Dalja e llavës, hirit, gazrave, tymit në sipërfaqen e Tokës quhet shpërthim vullkanik. Shtresimi, ftohja dhe ngurtësimi i llavës krijon lartësi relievi të quajtur kupë vullkanike.

Disa vullkane kanë qenë aktive, domethënë kanë pasur shpërthime vullkanike, vetëm në të kaluarën shumë të largët, kurse disa vullkane janë aktive edhe sot.

Në viset ku ka vullkane mund të shfaqen burime të quajtura gejzerë. Këto burime, si ujëvarë, herë pas here hedhin rryma uji të nxehtë në ajër.

Gejzeri

Tërmetet janë lëkundje të shpejta dhe të papritura të pjesëve të kores së Tokës. Ato ndodhin për shkak të zhvendosjes së shtresave brenda kores së Tokës, gjatë shpërthimi vullkanik ose gjatë shembjes së zgavrave nëntokësore. Kur ndodh ndonjë tërmet, një sasi e madhe energjie lirohet që në sipërfaqen e tokës ndjehet sikur toka po dridhet.



Hipoqendra dhe epiqendra e tërmetit

Vendi ku ndodh tërmeti në sipërfaqen e Tokës quhet hipoqendër. Epiqendra është pika në sipërfaqen e Tokës që është mbi hipoqendrën dhe ku tërmeti ndihet më fort.

Shumica e tërmeteve janë të dobëta, kështu që njerëzit nuk i ndjejnë. Tërmetet e forta ndodhin më rrallë. Si pasojë e tërmeteve të forta që ndodhin nën fundin e detit mund të formojë valë të larta që quhen cunami. Çfarë pasojash mund të shkaktojnë këto valë?



Cunami

AKTIVITET

Eksperimenti i vullkanit dhe shpërthimit vullkanik

Bëj një model të vullkanit me plastelinë ose argjilë. Ki kujdes të modelosh të gjitha pjesët e vullkanit (kupën vullkanike, kraterin, kanalin dhe shtratin e magmës). Vendose modelin e përfunduar në bazë. Përmes kraterit dhe kanalit vullkanik deri pranë shtratit mbi magmë vendos piper të kuq, më pas sodë buke dhe uthull. Shpjego se çfarë po ndodh?

Do të të duhet:
kuti mat, plastelinë ose argjilë, piper i kuq, sodë buke dhe uthull.

MENDO!

Çfarë do të bëje nëse do të ishe në klasë gjatë tërmetit?

PYETJE

1. Çfarë është vullkani?
2. Shpjego se si formohet vullkani!
3. Cili është ndryshimi midis magmës dhe lavës?
4. Ku është hipoqendra dhe ku është epiqendra e tërmetit?

ÇFARË KE MËSUAR

- Vullkani është vend në sipërfaqen e Tokës ku llava, gazrat, hiri, tymi nxirren nga brendësia e Tokës.
- Tërmetet janë lëkundje të shpejta dhe të papritura të pjesëve të kores së Tokës.

1.4 FORMIMI I RELIEVIT NËN VEPRIMIN E FORCAVE TË JASHTME

FJALË PËR TË MËSUAR:

forca të jashtme, erozion, akumulim

Pasi formohen format e mëdha të relievit nën ndikimin e forcave të brendshme, mbi to fillojnë të veprojnë forcat e jashtme. Rikujtohu se forcat e brendshme dhe të jashtme veprojnë vazhdimisht në sipërfaqen e Tokës, kështu që relievi ndryshon vazhdimisht.

Forcat e jashtme që veprojnë në formimin e relievit janë nxehtësia diellore, uji dhe era. Rrezet e diellit bien në kënd të ndryshëm në pjesë të ndryshme të Tokës, kështu që ngrohja dhe ftohja e sipërfaqes së Tokës është e ndryshme. Temperaturat më të larta të ajrit i zgjerojnë shkëmbinjtë, ndërsa temperaturat më të ulëta i tkurrin ato. Ky zgjerim dhe tkurrje e alternuar e shkëmbinjve shkakton shkatërrimin e tyre. Nëse ka ujë në të çarat e shkëmbinjve, ai ngrin në temperatura të ulëta dhe shndërrohet në akull.

Akulli ka vetinë të zgjerohet gradualisht, prandaj shkakton fillimisht zgjerimin e çarjeve dhe më pas plasaritjen e shkëmbinjve. Uji gjithashtu ka efekt tretës në disa shkëmbinj, gjë që ndikon në formimin e formave të veçanta të relievit. Era vepron duke lëvizur materialin shkëmbor të dekompozuar, i cili është i imët, duke u fërkuar me nënshtresën.



Shfaqja e erozionit dhe akumulimit

Të gjitha forcat e jashtme shkaktojnë plasaritje, thërrmim dhe imtësim të shkëmbinjve. Ky proces i prishjes së shkëmbinjve quhet erozion.
Me ndihmën e ujit dhe të erës materiali shkëmbor i grimcuar transferohet nga një vend në tjetrin dhe kryhet shtresimi i tij. Procesi i shtresimit të materialit shkëmbor të gërryer është i njohur si akumulim.

AKTIVITET

Do të të duhet:
tabaka, rërë e imët dhe shishe plot me ujë.

Eksperimenti i erozionit dhe akumulimit

Vendose tabakanë në sipërfaqe të pjerrët.
Më pas, vendose rërën në pjesën më të lartë të tabakasë dhe shtype.

Sigurohu që pjesa e poshtme e tabakasë të jetë bosh, pa rërë. Nëpër rërë, me gisht, bën një vijë të lakuar, duke lëvizur nga pjesa më e lartë në pjesën më të ulët. Më në fund, derdh ujin nga shishja në vijën e gdhendur.

Çfarë ndodh, a lëviz rëra? Cilat dy procese i vëzhgove me eksperimentin?

MENDO!

Pse njerëzit nuk mund të vërejnë formimin e disa formave të tokës (p.sh. shkretëtirës, plazhit, shpellës)?

PYETJE

1. Shpjego se si forcat e jashtme veprojnë në formim e relievit!
2. Cili është ndryshimi midis erozionit dhe akumulimit?

ÇFARË KE MËSUAR

- Në formimin e relievit të Tokës veprojnë forcat e jashtme.
- Nxehtësia diellore, uji dhe era janë forca të jashtme që formojnë relievin.
- Erozioni është procesi i shkatërrimit të shkëmbinjve dhe akumulimi është procesi i shtresimit të materialit të shkatërruar.

1.5 LLOJET E RELIEVIT

FJALË PËR TË MËSUAR:

reliev vullkanik, reliev detar, reliev liqenor, reliev akullnajor, reliev i shkretëtirës, reliev lumor, reliev karstik

Relievi i planetit Tokë formohet nën veprimin e forcave të brendshme dhe të jashtme. Përkujtohu cilat janë forcat e brendshme dhe cilat janë forcat e jashtme! Në varësi të forcës natyrore që vepron në sipërfaqen e Tokës, formohen lloje të ndryshme të relievit.

Relievi vullkanik ndodh në vendet ku ka pasur vullkane aktive në të kaluarën ose sot. Format e tokës të formuara nga ngurtësimi i llavës së nxjerrë nga vullkanet e përbëjnë relievin vullkanik. Rikujtohu ku ka vullkane dhe si formohen kupat vullkanike!

Formimi i relievit vullkanik

Format e relievit të krijuara nën veprimin e valëve

Dallgët në dete dhe liqene kanë ndikim në formimin e relievit përgjatë bregdetit. Duke goditur bregun, dallgët i thyejnë dhe i shembin shkëmbinjtë dhe më pas materiali i copëtuar shtrohet përgjatë bregut. Format e relievit të formuara përgjatë deteve janë pjesë e relievit detar dhe format e relievit përgjatë liqeneve janë pjesë e relievit liqenor.

Relievi i shkretëtirës formohet nën ndikimin e erës në shkretëtira. Dallimi midis temperaturave të larta të ditës dhe të ulëta të natës të ajrit bën që shkëmbinjtë të thërrmohen. Ky material me ndihmën e erës transportohet nga një vend në tjetrin.

Sahara është shkretëtira më e madhe në botë



Shpërndarja e shkretëtirave sipas kontinenteve

Malet e larta dhe viset rreth Poleve Veriore dhe Jugore të Tokës zakonisht kanë temperatura të ulëta të ajrit dhe reshjet përfaqësohen nga bora. Për shkak të temperaturave të ulëta bora është shtresuar dhe kthehet në akull. Kështu formohen akullnajat. Format e relievit që ndodhin me lëvizjen dhe punën e akullnajave formojnë relievin akullnajor ose glacial.

Forma relievore të krijuara nën veprimin e ujit të lumit

Relievi karstik ndodh në shkëmbinj që treten nga uji. Uji krijon forma si në sipërfaqen e tokës, ashtu edhe në brendësi të saj.

Në këtë rrugë, rëra, për shkak të fërkimit me nënshtresën, është edhe më e imët dhe formon forma të ndryshme relievore.
Vetëm kontinentet e Evropës dhe Antarktidës nuk kanë shkretëtira. Mundohu t'i gjesh në hartën gjeografike dhe t'i emërtosh shkretëtirat më të mëdha në kontinente të tjera!

Akullnaja Lambert në Antarktidë është më e gjata në Tokë

Relievi lumor formohet me ndihmën e ujit nga lumenjtë. Uji e gërryen materialin shkëmbor rreth lumit dhe e shtreson në vendet ku shpejtësia e ujit të lumit zvogëlohet.

Shpellat janë formacione karstike nëntokësore

AKTIVITET

Do të të duhet:
tabaka, rërë e imët dhe kashtë.

Eksperimenti i formimit të relievit të shkretëtirës

Vendose tabakanë në sipërfaqe të rrafshët.
Më pas rërën vendose në njërin skaj të tepsisë. Ki kujdes, pjesa tjetër e tepsisë duhet të jetë e zbrazët, pa rërë. Merre kashtën, afrojani rërës dhe filloni të fryni në të. Çfarë force natyrore përfaqëson fryrja përmes kashtës? Çfarë vëren, çfarë ndodh me rërën? A lëviz ajo në pjesën e zbrazët të tabakasë? A mund ta marrësh me mend se çfarë lloj relievi është formuar në këtë mënyrë?

MENDO!

A mund të identifikoni ndonjë lloj relievi në rrethinat e vendbanimit tënd? Cilat forca natyrore kanë vepruar në formimin e tij?

A mundet njeriu me aktivitetet e tij të ndikojë në ndryshimin e relievit?

PYETJE

1. Numëro tre lloje të relievit dhe shpjego se çfarë forca natyrore i formon ato!

ÇFARË KE MËSUAR

- Relievi vullkanik formohet nën veprimin e shpërthimeve vullkanike.
- Format tokësore të detit dhe liqenit formohen nga dallgët.
- Relievi i shkretëtirës formohet nën ndikimin e erës në shkretëtira.
- Relievi akullnajor ose glacial formohet nga akullnajat.
- Relievi lumor formohet nën ndikimin e ujit të lumit.
- Relievi karstik formohet nga shkëmbinjtë që tretin ujë.

1.6 SHKËMBINJTË

FJALË PËR TË MËSUAR:

shkëmbinj vullkanikë, shkëmbinj të shtresuar, shkëmbinj të ndryshuar

Litosfera ose guaska e fortë shkëmbore e Tokës, përbëhet nga shkëmbinj të ndryshëm. Ata ndryshojnë nga njëri-tjetri sipas vjetërsisë, përbërjes kimike, vetive fizike, mënyrës së formimit etj. Sipas mënyrës së formimit, shkëmbinjtë mund të jenë vullkanikë, të shtresuar dhe të ndryshuar.

Shkëmbinjtë vullkanikë formohen në sipërfaqen e tokës nga ftohja dhe ngurtësimi i lavës nga vullkanet ose nga ngurtësimi i magmës brenda litosferës. Graniti, bazalti, dioriti, diabazi, gabro përfaqësojnë shkëmbinj vullkanikë.

graniti

bazaliti

andeziti

Shkëmbinjtë në sipërfaqen e Tokës janë të ekspozuar ndaj veprimit të forcave të jashtme. Rikujtohu se si forcat e jashtme veprojnë në sipërfaqen e Tokës! Me erozion grimcohen dhe thërrmohen dhe më pas me ndihmën e ujit dhe të erës lënda e thërrmuar bartet në vend tjetër (në tokë ose në sipërfaqe ujore), ku depozitohet. Kur ky material i shtresuar ngurtësohet, formohet shkëmbi me shtresa. Rëra, argjila, kripa e tryezës, guri gëlqeror janë përfaqësues të shkëmbinjve me shtresa.

guri gëlqeror

kripa e gurit

argjila

Shkëmbinjtë e ndryshuar formohen nga transformimi i shkëmbinjve vullkanikë tashmë të formuar ose shkëmbinj me shtresa. Temperaturat e larta dhe presionet e larta që mbizotërojnë në shtresat e brendshme të Tokës ndryshojnë vetitë

fizike dhe kimike të shkëmbinjve të formuar më parë dhe krijojnë një lloj të ri shkëmbi. Për shembull, duke ndryshuar vetitë e shkëmbit vullkanik granit, fitohet shkëmbi i ndryshuar i gneisit ose duke ndryshuar vetitë e shkëmbit gëlqeror të shtresuar, fitohet shkëmbi i ndryshuar i mermerit.

mermeri

gneisi

AKTIVITET

Do të të duhet:
gips guri, gur granit, çekiç, ujë, letër dhe laps.

Aktiviteti i testimit të veçorive të shkëmbit

Analizo shkëmbinjtë sipas ngjyrës, fortësisë dhe ashpërsisë. Shkruaji veçoritë në letër.
Më pas, vendosi shkëmbinjtë në sipërfaqe të rrafshët dhe derdhi një rrjedhë uji mbi to. Çfarë ndryshime ndodhin me gipsin dhe çfarë ndodh me granitin? Me ndihmën e personit të rritur, përpiqu të thyesh të dy shkëmbinj me çekiç. A ke vënë re se cili shkëmb është më i lehtë për t'u thyer? Shkruaji të gjitha tiparet dhe ndryshimet e vërejtura në letër me laps. A e di se mund të ekzaminosh në mënyrë të pavarur vetitë fizike të shkëmbinjve?

MENDO!

Si i përdor njeriu gurët në jetën e përditshme?

PYETJE

1. Si ndahen shkëmbinjtë sipas mënyrës së formimit?
2. Si formohen shkëmbinjtë vullkanikë, të shtresuar dhe të ndryshuar?

ÇFARË KE MËSUAR

- Sipas mënyrës së formimit, shkëmbinjtë ndahen në vullkanikë, të shtresuar dhe të ndryshuar.
- Shkëmbinjtë vullkanikë formohen nga ftohja dhe ngurtësimi i lavës ose magmës.
- Shkëmbinjtë shtresorë formohen nga shtresimi i materialit të copëtuar në tokë ose në mjedis ujor.
- Shkëmbinjtë e ndryshuar formohen nga ndryshimi i shkëmbinjve vullkanikë ose të shtresuar nën ndikimin e presioneve të larta dhe temperaturave të larta.

1.7 PËRBËRJA DHE NDARJA E ATMOSFERËS

FJALË PËR TË MËSUAR:

atmosferë, oksigjen, azot, dioksid i karbonit, avuj uji, pluhur, troposferë, stratosferë, ozonosferë, jonosferë, ekzosferë

Ajri që mbulon planetin Tokë quhet atmosferë. A të kujtohet se është përzierje gazesh? Azoti dhe oksigjeni janë gazrat më të zakonshëm në ajër, por ka edhe dioksid karboni, avuj uji, pluhur dhe substanca të tjera.

Atmosfera mbron planetin tonë nga ngrohja dhe ftohja e tepërt. Pa të nuk do të kishte jetë në Tokë. Pse atmosfera është e rëndësishme për mbijetesën e gjallesave?

Atmosfera është e ndarë në disa shtresa. Shtresa më e ulët quhet troposferë. Ajri në të është më i dendur dhe në të bëhet lëvizja rrethore e ujit, krijohen re dhe reshje të ndryshme, fryn erë, fluturojnë shpezë etj. Mbi të është stratosfera. Ajri në këtë mbështjellës është më i rrallë. Në të ka shtresë të gazit të ozonit që e mbron Tokën nga rrezet e dëmshme të diellit. Kjo është arsyeja pse kjo shtresë quhet edhe ozonosferë. Jonosfera dhe ekzosfera janë mbështjelljet më të jashtme nga Toka dhe në to ajri është shumë i rrallë.



Elementet më të bollshme në atmosferë



Ndarja e atmosferës

AKTIVITET

Do të të duhet:
dy kavanoza, kapak kavanozi, dheu dhe dy bimë më të vogla me lule.

Eksperimenti mbi rëndësinë e oksigjenit në troposferë

Vendose tokën në kavanoza dhe mbilli dy bimët. Njërin kavanoz e mbyll me kapak dhe tjetrin e lë të hapur. Vëzhgoji bimët në kavanoza për disa ditë. Çfarë ndodh me bimët? Cila bimë do të mbijetojë dhe pse?

MENDO!

Si bëhet pluhuri dhe hiri pjesë përbërëse e mbështjellësit të ajrit?

Pse bota e gjallë në planetin Tokë nuk mund të mbijetojë në shtresat e sipërme të atmosferës?

PYETJE

1. Çfarë është atmosfera dhe çfarë rëndësie ka për Tokën?
2. Nga cilët mbështjellës përbëhet atmosfera?

ÇFARË KE MËSUAR

- Atmosfera është mbështjellës ajror i Tokës.
- Ajri është përzierje e disa gazeve dhe materieve të tjera.
- Atmosfera përbëhet nga troposfera, stratosfera, jonosfera, ekzosfera.

1.8 ELEMENTET METEOROLOGJIKE

FJALË PËR TË MËSUAR:

temperaturë e ajrit, ngrohje globale, presion i ajrit/atmosferës, lagështi e ajrit, termometër, barometër, psikrometër

A të kujtohet se moti është gjendja momentale e atmosferës mbi ndonjë vend. Mund të ndryshojë disa herë gjatë ditës dhe të jetë me diell, me vranësira, me borë, me erë etj. Moti varet nga disa elemente meteorologjike, si: temperatura e ajrit, presioni i ajrit, lagështia e ajrit etj. Elementet meteorologjike janë vazhdimisht të pranishme në atmosferë dhe vlerat e tyre maten duke përdorur instrumente meteorologjike që vendosen në shtëpizë meteorologjike. Të dhënat e marra nga këto instrumente ndihmojnë për të parashikuar motin për ditët në vijim.

Ndarja e atmosferës

Rrezet e diellit ngrohin tokën dhe ujin e Tokës. Si trupa të nxehtë, ato rrezatojnë nxehtësi dhe kështu e ngrohin ajrin. Së pari ajri që është afër tokës dhe ujit ngrohet dhe kur shkon në lartësi më të madhe, temperatura e ajrit është më e ulët. Përcakto nëse temperatura e ajrit është më e lartë në breg të detit apo në majë të mali! Temperatura e ajrit matet me termometrin e instrumentit dhe shprehet në gradë Celsius (°C).

Aktivitetet njerëzore në sipërfaqen e Tokës (industria, trafiku, zgjerimi urban) dhe përdorimi i tepërt i lëndëve djegëse fosile (qymyri, nafta, gazi natyror) shkaktojnë rritje të temperaturës së ajrit në troposferë, veçanërisht afër Tokës. Ky fenomen quhet ngrohje globale.

Ngrohja globale shkakton fatkeqësi natyrore si zjarre në pyje, shkrirje të akullnajave, ngritje të nivelit të detit, përmbytje, pra efekte negative në mjedisin jetësor.

Si të gjitha substancat, edhe ajri ka peshën e vet. Me të ai ushtron presion mbi trupat e Tokës. Ky presion i ajrit quhet presion ajror ose atmosferik. Ai matet me instrumentin e barometrit dhe shprehet në paskal (Pa).



Barometri

Me avullimin e ujit nga oqeanet, detet dhe ujërat tokësore krijohet avulli i ujit, i cili është pjesë e ajrit. Sasia e avullit të ujit në ajër quhet lagështi e ajrit. Lagështia e ajrit matet me instrumentin psikrometër.

Psikrometri

AKTIVITET

Eksperimenti për të bërë termometër

Mbush ¼ nga shishja me ujë dhe alkool. Sigurohu që uji dhe alkooli të jenë në të njëjtin raport. Më pas, shtoi disa pika ngjyrues ushqimor. Vendose kashtën në shishe, por mos e lër të prekë fundin. Bëj një sipërfaqe të rrafshët me argjilën e modelimit dhe fikso kashtën në të. Ngrohi duart dhe vendosi në fund të shishes. Shiko se si përzierja lëviz nëpër kashtë. A mund të shpjegosh pse përzierja lëviz nëpër kashtë?

Do të të duhet:
shishe më e madhe plastike e pastër, ujë, alkool, kashtë plastike e pastër, argjilë modeluese dhe ngjyrosje ushqimore.

MENDO!

A mund të ndikojë njeriu në motin dhe klimën? Arsyetoje mendimin tënd!

PYETJE

1. Pse është i nevojshëm monitorimi i rregullt i vlerave të elementeve meteorologjike?
2. Cilat instrumente përdoren për matjen e elementeve meteorologjike dhe ku vendosen ato?

ÇFARË KE MËSUAR

- Temperatura e ajrit është shkalla e ngrohjes së ajrit.
- Ajri ose presioni atmosferik është presioni që ushtron ajri mbi trupat në Tokë.
- Lagështia e ajrit është sasia e avullit të ujit në ajër.

1.9 DUKURITË METEOROLOGJIKE

FJALË PËR TË MËSUAR:

dukuri meteorologjike, erë, reshje, mjegull, lopatë e erës, matës i shiut

Dukuritë meteorologjike janë ato që ndodhin herë pas here dhe maten vetëm kur ndodhin. Duke i ndjekur ato, mund të përcaktosh se si do të jetë moti në ditët në vijim. Të tilla dukuri janë: era, mjegulla, reshjet.

Erëtreguesi

Për shkak të ajrit të ngrohur në mënyrë të pabarabartë, ndodh lëvizje ose rrjedhje e ajrit. Ajri më i ngrohtë është më i lehtë dhe për këtë arsye ngrihet në lartësi më të madhe. Përkundrazi, ajri i ftohtë, duke qenë më i rëndë, zbret më poshtë.
Rryma e ajrit quhet erë. Drejtimi i erës matet me instrumentin e korsisë së erës. Ky instrument vendoset pranë shtëpisë meteorologjike, në hapësirë më të lartë dhe të hapur.

Tashmë e di se uji që avullohet nga oqeanet, detet dhe toka si avull uji, në atmosferë ftohet, kështu që kondensohet. Kondensimi i avullit të ujit në shtresat tokësore të troposferës krijon mjegull, kurse retë krijohen në pjesët më të larta. Pikat e ujit që formohen në re quhen reshje. Cilat lloje të reshjeve i dallon? Sasia e reshjeve matet me instrumentin shimatës dhe shprehet në milimetra (mm). Matësi i shiut vendoset në hapësirë të hapur.

Shimatësi

AKTIVITET

Do të të duhet:
kavanoz, vizore dhe kompjuter.

Eksperimenti për të bërë shimatës

Përpara se të fillojë të bjerë shi, vendose kavanozin jashtë. Kur fillon të bjerë shi, nëse shiu e mbush kavanozin, ai është i vendosur mirë. Pasi të ketë mbaruar shiu, përdor vizoren për të matur sa milimetra shi ranë në pikën e matjes. Shënoji vlerat e reshjeve në tabelë. Përsërite procedurën gjatë disa reshjeve të njëpasnjëshme. Më në fund, mund të krijosh grafik dhe të analizosh sasinë e reshjeve që ranë për një periudhë të caktuar.

Shpjego rezultatet e fituara!

MENDO!

Shpjego kur themi se erërat dhe reshjet kanë ndikim pozitiv dhe kur kanë ndikim negativ!

Pse erëtreguesi dhe shimatësi nuk vendosen në shtëpizën meteorologjike, por në hapësirë të hapur?

PYETJE

1. Shpjego një fenomen meteorologjik!

ÇFARË KE MËSUAR

- Era është rrymim i ajrit.
- Pikat e ujit që formohen në re quhen reshje.

1.10 FAKTORËT KLIMATIKË DHE BREZAT TERMIKË

FJALË PËR TË MËSUAR:

faktorë klimatikë, ekuator, lartësi mbidetare, reliev, breza termikë

Duke vëzhguar elementet dhe dukuritë meteorologjike në hapësirë të caktuar për shumë vite, mund të përcaktohet gjendja mesatare e atmosferës. A të kujtohet se kjo quhet klimë? Klima varet nga disa faktorë klimatikë.

Rrezet e diellit ngrohin më shumë në territoret përreth ekuatorit, prandaj klima është e ngrohtë. Me largimin nga ekuatori, klima bëhet më e ftohtë, sepse ngrohja është më e vogël. Si duhet të jetë klima në Polin Verior dhe Jugor të Tokës?

Relievi dhe lartësia mbidetare ndikojnë në klimën. Malet e larta paraqesin pengesë për lëvizjen e masave ajrore. Kështu, malet që ndodhen pranë detit kanë më shumë reshje dhe klimë më të lagësht në krahasim me malet që ndodhen në brendësi të kontinentit, të cilat kanë më pak reshje dhe klimë më të thatë. Fushat e ulëta nuk paraqesin pengesë për erën. Me rritjen e lartësisë mbidetare, temperatura e ajrit zvogëlohet dhe sasia e reshjeve rritet.



Relievi dhe lartësia mbidetare përfaqësojnë faktorin klimatik



Brezat e nxehtësisë së Tokës

Tashmë e di se rrezet e diellit e ngrohin sipërfaqen e Tokës. Por ato nuk bien në të njëjtin kënd në sipërfaqen e Tokës. Aty ku këndi i rrezeve të diellit është më i madh, ngrohja është më e madhe dhe për këtë arsye është më ngrohtë. Në të kundërt, nëse këndi në të cilin bien rrezet e diellit është më i vogël, atëherë ngrohja është më e vogël dhe për këtë arsye është më ftohtë. Për shkak të ngrohjes së ndryshme, në Tokë dallohen pesë breza të nxehtësisë. Ato janë: brezi i nxehtë, i butë verior dhe jugore, i ftohtë verior dhe jugor.

Brezi i nxehtë i nxehtësisë shtrihet në veri dhe në jug të ekuatorit. Kjo pjesë e Tokës merr më shumë dritë dhe nxehtësi gjatë vitit në krahasim me rajonet e tjera. Kjo është arsyeja pse këtu ka vetëm një stinë - verë.

Në veri të brezit të nxehtë - në hemisferën veriore është brezi verior i nxehtësisë së butë, kurse në jug të brezit të nxehtë - në hemisferën jugore është brezi jugor i nxehtësisë së butë. Në këto breza rrezet e diellit bien në kënd tjetër gjatë gjithë vitit, prandaj ngrohja është ndryshe. Për shkak të kësaj, në këto rajone ka ndryshim prej katër stinëve: pranverë, verë, vjeshtë dhe dimër.

Në rajonet përreth Polit Verior është brezi verior i nxehtësisë së ftohtë, kurse në rajonet përreth Polit Jugor është brezi jugor i nxehtësisë së ftohtë. Këtu rrezet e diellit bien në kënd të vogël dhe sasia më e vogël e nxehtësisë merret nga Dielli. Prandaj, gjatë gjithë vitit ka vetëm një stinë - dimri.

AKTIVITET

Kërko në hartën gjeografike ose në glob nga tre shtete që i përkasin brezit të nxehtësisë së nxehtë, brezit verior dhe jugor të nxehtësisë së butë dhe brezit verior dhe jugor të nxehtësisë së ftohtë!

Do të të duhet:
hartë gjeografike ose glob.

MENDO!

Në cilat breza të nxehtësisë ka kushte më të favorshme për të jetuar? Shpjego pse!

PYETJE

1. Numëro disa faktorë nga të cilët varet klima!
2. Sa breza të nxehtësisë ka në Tokë dhe cilat janë karakteristikat e tyre?

ÇFARË KE MËSUAR

- Largësia nga ekuatori, lartësia mbidetare dhe relievi janë faktorë që ndikojnë në karakteristikat e klimës.
- Brezat termikë janë rajone të Tokës që ndahen sipas këndit në të cilin bien rrezet e diellit dhe ngrohjes së tyre. Ekzistojnë pesë breza të nxehtësisë: i nxehtë, e butë verior, i butë jugor, i ftohtë verior dhe i ftohtë jugor.

1.11 NDIKIMI I KLIMËS NË SHPËRNDARJEN GJEOGRAFIKE TË JETËS BIMORE DHE SHTAZORE

FJALË PËR TË MËSUAR:

pyje tropikale ekuatoriale, savana, stepa, shkretëtira, pyje gjetherënëse, pyje halore, kullota, tajgë, tundër

Klima ka ndikim të madh në përfaqësimin e jetës bimore dhe shtazore. Temperatura e ajrit, reshjet dhe faktorë të tjerë ndikojnë që pjesë të ndryshme të planetit Tokë të kenë përfaqësues të ndryshëm të bimëve dhe kafshëve.

Në rajonet përreth ekuatorit gjatë gjithë vitit ka temperatura të larta të ajrit dhe shumë reshje. Prandaj, klima është e nxehtë dhe e lagësht. Në kushte të tilla, formohen pyje të dendura dhe të pakalueshme që quhen pyje shiu ekuatorial. Ato kanë më shumë bimë dhe kafshë në planetin Tokë. Përfaqësuesit e botës bimore janë palma, liana, bambusi, tiku, kurse nga kafshët hasen majmunët, krokodilët, gjarpërinjtë, shpezët dhe insektet e ndryshme. Këto pyje janë të shpërndara në Amerikën e Jugut, në pjesët qendrore të Afrikës dhe në pjesët jugore të Azisë.

Pyjet ekuatoriale të shiut

Savana

Në viset veriore (në hemisferën veriore) dhe në viset jugore (në hemisferën jugore) të pyjeve të shiut ekuatorial, reshjet janë më pak të shpeshta dhe temperatura e ajrit është e lartë gjatë gjithë vitit. Këtu ka vise barishtore me barëra të gjatë dhe më pak pemë që quhen savana. Elefantët, gjirafat, luanët, zebrat janë pjesë e botës së kafshëve.

Në brezat me nxehtësi të butë, në viset me pak reshje dhe temperatura të larta të ajrit ka klimë të thatë. Këtu ka vise barishtore me bar të ulët të quajtur stepa. Ka shkretëtira në rajone ku reshjet ndodhin rrallë. A mund të përkujtohesh për ndonjë shkretëtirë?

Stepa

Shkretëtira

Në shkretëtirat ka jetë të pakët bimore të përfaqësuar nga kaktusët, kurse nga bota shtazore ka deve, dhelpra të shkretëtirës, hiena, gjarpërinj, akrepa e të tjera.

Në brezin e butë verior dhe jugor ka ndryshim të stinëve. Temperatura e ajrit është mesatare, kurse reshjet janë në formë shiu dhe bore. Më të përhapurit në këto vise janë pyjet gjetherënëse, përfaqësues të të cilëve janë lisi, ahu, gështenja, panja, mështekna e të tjera. Nga kafshët hasen ujqit, dhelprat, derrat e egër, ketrat, shpendët e ndryshëm. A e kuptoni se kjo botë e gjallë është veçori edhe e atdheut tonë?

Në malet e larta dhe në kalimin nga brezi i butë verior në brezin e ftohtë termik verior, ka dimër të gjatë dhe të ftohtë dhe verë të shkurtër dhe të freskët. Kjo është arsyeja pse pyjet gjetherënëse dhe halore shfaqen në pjesët veriore të Amerikës së Veriut, Evropës dhe Azisë. Në këto rajone pyjet halore me pisha dhe bredh quhen tajga. Arinjtë, ujqërit dhe kafshët e tjera jetojnë në këto pyje.

Taiga

Tundra

Në brezat e ftohtë të nxehtësisë, për shkak të temperaturave të ulëta të ajrit dhe sasisë së vogël të reshjeve, jeta e bimëve është e pakët. Pjesa më e madhe e vitit, sipërfaqja e tokës është e ngrirë dhe gjatë temperaturave më të larta akulli shkrihet dhe krijohen këneta në të cilat rriten myshqet, likenet, mështekna dhe shelgjet polare. Këto vise njihen si tundra. Arinjtë polarë, dhelprat polare, lepujt polarë jetojnë në këto rajone. Pinguinët jetojnë vetëm në hemisferën jugore.

AKTIVITET

Krijo hartë memece të botës. Pastaj, bëj disa kërkime në internet për disa bimë dhe kafshë interesante. Printo foto të ndryshme nga ato dhe ngjitini në vendin e duhur në hartën memece. Cili është përfundimi yt, planeti i Tokës a është shtëpia e një numri të madh të llojeve bimore dhe shtazore?

Do të të duhet:
Hartë memece, kompjuter me internet, printer, ngjitës.

MENDO!

A janë të njëjtat bimë dhe kafshë që banojnë në Tokë që nga formimi i saj e deri më sot? Nëse përgjigjja juaj është jo, shpjego pse dhe cila është arsyeja për këtë!

PYETJE

1. Ku rriten pyjet tropikale ekuatoriale dhe pse në to ka botë të larmishme bimore dhe shtazore?
2. Çfarë janë savanat dhe çfarë janë stepat?
3. Cilat janë karakteristikat e tundrës dhe ku ndodhet ajo?

ÇFARË KE MËSUAR

- Pyjet tropikale ekuatoriale janë pyje të dendura dhe të padepërtueshme që gjenden përreth ekuatorit.
- Savanat janë vise barishtore me bar të lartë dhe më pak pemë.
- Stepet janë vise barishtore me bar të ulët.
- Shkretëtirat janë rajone në të cilat ka reshje të rralla.
- Taiga janë rajone me pyje halore me pisha dhe bredha që ndodhen në kalimin nga brezi i butë verior në atë të ftohtë verior të nxehtësisë.
- Tundra është rajon moçalor në breza të ftohtë në të cilën rriten myshqet, likenet, mështeknat polare dhe shelgjet polare.

- Mjediset jetësore ujore janë ekosistemet e mëdha të kripura ujore, detet dhe oqeanet, dhe ujërat e ëmbla tokësore si; janë rrjedhjet dhe jo-rrjedhjet ujore.
- Disa organizma të gjallë jetojnë vetëm në ujë, të tjerët vetëm në bashkësitë e jetës tokësore, kurse të tjerët në të dyja.

3.3 PËRSHTATJA E ORGANIZMAVE TË GJALLË ME KUSHTET NË MJEDISIN JETËSOR

FJALË PËR TË MËSUAR:

përshtatje, kamuflazh, letargji, migrim, estivim, simbiozë, grabitqar, pre

Në mjedisin jetësore të ndryshme jetese organizma të ndryshëm të gjallë duan t'i sigurojnë vetes kushte më të mira jetese. Kjo është arsyeja pse ato konkurrojnë me njëri-tjetrin. Kështu, vemjet që ushqehen me gjethet e bimëve kërkojnë pjesë të mjedisit jetësor ku ka bimë me gjethe.

Në mjedisin jetësor ka edhe konkurrencë për individët e gjinisë tjetër, kështu që luanët meshkuj luftojnë për territor në të cilin kujdesen për femrat.

Gjethet e bimëve e duan dritën që u nevojitet për të bërë ushqim, kështu që në pyje disa janë të shkurtra, disa të mesme dhe disa janë shumë të larta. Në këtë mënyrë të gjithë kanë pjesë të dritës.

Përshtatja

Mënyrat në të cilat organizmat përshtaten në vendbanimet e tyre dhe mbijetojnë në to njihen si **përshtatje**. Duke vëzhguar përshtatjet e një kafshe ose bimëve mund të japësh ide se ku dhe si jeton.

Qafa e gjatë e gjirafës e lejon atë të ushqehet me gjethe nga majat e pemëve të cilat vështirë se mund t'i arrijë ndonjë kafshë tjetër

Kështu, luani ka zhvilluar dhëmbë për këputjen e mishit dhe thyerjen e kockave. Fluturat kanë gjuhë gypore me të cilën mund të ushqehen me nektarin e luleve.

Shumë bimë kanë lule me ngjyra të ndezura për të tërhequr insektet për polenizim.

Bimët e shkretëtirës shpesh ruajnë ujë në kërcell, gjethe ose rrënjë. Shembujt më të njohur janë kaktusët.

Kaktusi që pikon ujë

Kamuflazhi

Nëse ecim nëpër pyll në shikim të parë nuk do t'i vëmë re kafshët rreth nesh. Ato janë të afta "të fshihen" nga shikimi ynë dhe nga armiku.

Kamuflazhi është ngjyrosja e mbulesës së jashtme të kafshës sipas mjedisit në të cilin jeton.

Për shembull, ngjyrat e drerëve dhe ketrave përputhen me ngjyrën e pemëve. Ngjyra e gjelbër e karkalecit është e njëjtë me gjethet e bimës.

Lepujt e malit janë kafe-gri në verë, gjë që i ndihmon ata të fshihen më lehtë nga grabitqarët. Gjatë dimrit leshi i tyre zbardhet, kështu që ata mund të maskohen më mirë në borë.

INTERESANTE!

Disa flutura që jetojnë në kërcellin e bimëve kanë të njëjtën ngjyrë si kërcelli. A mund ta marrësh me mend pse?

Lepuri malor në dimër dhe në verë

AKTIVITETI 1

Një nga kafshët më të njohura që përdor kamuflazh është iguana.
Kërko në internet fotografi të iguanas dhe lexo më shumë rreth kësaj kafshe.

Letargjia dhe migrimi

Disa kafshë në temperatura të ulëta ose të larta të jashtme dhe në mungesë ushqimi në periudhën e dimrit ose verës hyjnë në gjendje **letargjie** (gjumë dimëror) ose **estivim** (gjumë veror). Atëherë kafshët pushojnë dhe nuk ushqehen. Kafshët që dimërojnë janë arinjtë, ketrat, lakuriqët e natës e të tjera, kurse disa kafshë të shkretëtirës estivojnë.

Ariu në gjumin e dimrit

Llojet e tjera të kafshëve kanë nevojë për ushqim, vendbanim dhe kushte të favorshme për riprodhim, kështu që për t'i siguruar ato shkojnë në udhëtime të gjata. Kur ky ndryshim i vendbanimit shoqërohet me ndryshimin e stinëve thuhet se ato **migrojnë**.
Migrojnë gjitarët, shpezët, peshqit dhe disa lloje fluturash. Më të njohur janë **shpezët shtegtarë**.

Dallëndyshet migrojnë në rajonet më të ngrohta në dimër

Nga peshqit është më interesant migrimi i ngjalave. Gjatë sezonit të shumimit ato udhëtojnë nga lumenjtë e Evropës në detin Sargas (afër Gjirit Meksikan). Prej aty, ngjalat e reja për një periudhë 4 vjeçare do të kthehen në vendin ku janë larguar prindërit e tyre.

MENDO!

Cilët shpezë nga ana jote nuk janë në dimër?

AKTIVITETI 2

Nëse është e mundur, organizohuni në klasë dhe bëni një shtëpi të vogël për të ushqyer harabela që nuk migrojnë, por qëndrojnë këtu dhe kanë nevojë për ushqim në dimër. Luteni ndonjë të rritur ta varë shtëpizën në pemë. Gjithashtu, ushqeni ndonjë pëllumb me thërrimet e mëngjesit të paktën një herë.

Simbioza

Shumë shpesh anëtarët e dy llojeve të ndryshme të organizmave të gjallë që jetojnë së bashku për një kohë të gjatë në të njëjtën bashkësi të gjallë lidhen me njëri-tjetrin dhe kanë **jetë** ose **simbiozë të përbashkët**. Më shpesh organizmi më i madh është nikoqir, dhe më i vogli është mysafir. Të dy llojet e organizmave që jetojnë së bashku mund të përfitojnë nga simbioza ose njëri mund të përfitojë dhe tjetri mund të dëmtohet. Tashmë kemi përmendur marrëdhënie të tilla midis lules dhe bletës. Por ka të tjera, për shembull disa lloje milingonash i mbrojnë pemët nga disa parazitë ose barngrënës. Nga ana tjetër, pemët ofrojnë strehim dhe ushqim për milingonat.

Rikujtohu! Cili ishte roli i bletës në polenizim dhe pse bleta e zgjedh lulen e asaj bime.

Grabitqari dhe gjahu

Kafshët kryesisht ushqehen me bimë, por ka edhe nga ato që ushqehen me kafshë të tjera. Kafsha që ushqehet me kafshë të tjera quhet **grabitqar**. Kafsha që vret dhe ha grabitqarin është gjah e tij. Kryesisht grabitqari është më i madh dhe më i fortë se gjahu. Siç shihet në figurë ku grabitqari është bretkosa dhe gjahu është insekti.

PYETJE

1. A mund të përshtaten edhe bimët në mjedisin jetësor e jashtëm? Jep të paktën një shembull.
2. Shumë kafshë mund të ndryshojnë ngjyrën ose kanë ngjyrë që përshtatet me mjedisin e tyre. Pse mendon se është e nevojshme për mbijetesë?
3. Pse migrojnë disa kafshë?
4. Pse disa kafshë bien në gjumë dimëror, kurse disa në gjumë veror?
5. Çfarë është jeta e përbashkët (simbioza) dhe përshkruaje lidhjen ndërmjet merimangës dhe bimës mbi të cilën ajo bën rrjetën e saj?

ÇFARË KE MËSUAR

- Përshtatja është adaptim me mjedisin në të cilin jetojnë organizmat.
- Kamuflimi është ndryshim në ngjyrën e trupit të kafshëve që i ndihmon ato të fshihen nga grabitqarët ose të gjejnë ushqim.
- Letargjia dhe estivimi përfaqësojnë mënyrë të "fjetjes" përmes kushteve të pafavorshme të vendbanimit.
- Migrimet janë lëvizje të kafshëve në kërkim të ushqimit, vendbanimit dhe kushteve të favorshme të jetesës.
- Simbioza është lidhja ndërmjet organizmave të gjallë që jetojnë për një kohë të gjatë në të njëjtin mjedis.
- Grabitqar është kafsha që ushqehet me kafshë të tjera. Gjahu është kafsha me të cilën ushqehet grabitqari.

3.4 NDIKIMI I NJERËZVE NË MJEDISIN JETËSOR

FJALË PËR TË MËSUAR:

shkatërrim i vendbanimit, ngrohje globale, kopshti i qelqtë

Njerëzit mund të ndikojnë në mjedisin jetësor pozitivisht dhe negativisht. Duke ndërtuar shtëpi, shkolla, qendra tregtare, fabrika, rrugë etj., ata i shkatërrojnë vendbanimet që ishin shtëpia e qindra bimëve dhe kafshëve. Këta janë shembuj të ndikimit negativ të njeriut.

Pyjet shkatërrohen me shpejtësi të madhe! Shpyllëzimi ndodh duke prerë pemët. Pse e bëjmë këtë?

Arsyet kryesore janë:

- për të mbledhur dru për prodhimin e mobiljeve dhe dru zjarri,
- për të krijuar vend për sipërfaqe bujqësore,
- për t'i hapur rrugë qyteteve,
- për t'u hapur rrugë minierave.

Kafshët kullosin në sipërfaqe që dikur ka qenë pyll

AKTIVITET

Me shokët e klasës bëj një listë të asaj që bën secili prej jush si aktivitet i përditshëm që mendon se ka efekt të dëmshëm në mjedisin jetësor. Për shembull, spërkatja me deodoransë dhe të ngjashme janë të dëmshme sepse shkatërrojnë ozonin. Gjithashtu pyetni prindërit për disa aktivitete të dëmshme. Ndani mendimet e tua dhe sugjeroni se si mund të ndryshohet ajo!

Ndotja e ajrit, ujit dhe tokës

Me djegien e lëndëve djegëse fosile rritet përqendrimin e dioksidit të karbonit në atmosferë, gjë që çon në ngrohjen globale. Akullnajat fillojnë të shkrihen, duke ngritur nivelin e detit dhe duke përmbytur shumë vendbanime bregdetare.

Njerëzit gjithashtu ndotin atmosferën me gazra të tjerë. Kështu, monoksidi i karbonit i liruar nga shkarkimi i makinave është gaz helmues.

Ne përdorim qymyrin dhe naftën për të prodhuar energji, por ato e ndotin shumë mjedisin jetësor.

Djegia e qymyrit dhe e naftës në fabrika dhe termocentrale lëshojnë gazra që e ndotin ajrin

Makinat, motoçikletat, autobusët dhe kamionët lëshojnë monoksid karboni me gazrat e shkarkimit

Njeriu me aktivitetet e tij krijon sasi të mëdha mbeturinash të cilat i hedh dhe kështu e ndot sipërfaqen e tokës. Vetëm një pjesë e vogël e tyre mund të zbërthehet. Shumica e tyre janë kanaçe, shishe qelqi ose plastike, çanta dhe pothuajse gjysma e të gjithave janë produkte letre.

Mënyra e dytë e shkatërrimit të sipërfaqes së tokës si pjesë e mjedisit jetësor është *prodhimi bujqësor* modern. Në bujqësinë moderne përdoren një numër të madh i preparateve mbrojtëse që shkatërrojnë botën e gjallë në shtresat sipërfaqësore të tokës. Nga ana tjetër, ato e ndotin edhe ujin që përdoret për ujitjen e tyre, i cili më pas derdhet në pjesët ujore të ekosistemit. Atje ai ujë është i dëmshëm për organizmat e gjallë në mjedisin jetësor ujor, si gafforet, peshqit dhe bimët. Shumë shpesh shkakton helmim dhe vdekje të peshqve të mëdhenj në ekosistemet ujore.

MENDO!

Pse mendon se pyjet quhen "mushkëritë" e Tokës?

PYETJE

1. Numëro tre efekte negative që vijnë nga shpyllëzimi.
2. Krahasoje tokën e zonës pyjore para dhe pas shpyllëzimit.
3. Shpjego pse blerja e mobiljeve të përdorura prej druri është mënyrë e mirë për ruajtjen e pyjeve.
4. Si gazrat për kopshtin e qelqtë e shkaktojnë ngrohjen globale?
5. Çfarë mund të bëhet për të parandaluar ngrohjen globale?

ÇFARË KE MËSUAR

- Shpyllëzimi ndodh kur njerëzit i shkatërrojnë pyjet duke prerë drunjtë.
- Shpyllëzimi ka efekt negativ në mjedisin jetësor.
- Nëse shkatërrojmë vendbanimin në të cilin jetojnë kafshët dhe bimët, ato nuk do të mbijetojnë.
- Ndotja e ajrit shkaktohet nga gazrat e shkarkimit dhe gazrat e emetuara gjatë djegies së qymyrit dhe naftës në fabrika dhe termocentrale. Ndotja ka efekt negativ në mjedisin jetësor dhe në shëndetin e njerëzve.

3.5 SHQETËSIMI I NJERIUT PËR MJEDISIN JETËSOR

FJALË PËR TË MËSUAR:

burime, riciklim, energji rinovuese, energji jo rinovuese

Njeriu me aktivitetet e tij krijon sasi të mëdha mbeturinash që i hedh në sipërfaqen e tokës. Pjesa më e madhe e mbetjeve përfundon në vendgrumbullim, ku thjesht hidhet ose mbulohet. Vetëm një pjesë e vogël e tyre mund të zbërthehet. Pjesa më e madhe e mbetjeve janë kanaçe, shishe qelqi ose plastike, qese dhe pothuajse gjysma e të gjithave janë produkte letre.

Deponitë kanë erë shumë të keqe dhe kanë efekt të dëmshëm në mjedisin jetësor përreth

Plehrat e ndotin mjedisin tonë jetësor. Ato duken të neveritshme, të pista dhe kanë erë të pakëndshme. Kanë efekt të dëmshëm edhe te kafshët që i hanë, duke pasur parasysh se ku është ushqim

Njerëzit kërkojnë shpëtimin nga këto substanca të dëmshme në mundësinë që ato të riciklohen dhe të përshtaten për përdorim të sërishëm.

AKTIVITET

Aktiviteti 1

Luteni arsimtarin të organizojë pastrim njëditor të mbeturinave në oborrin e shkollës ose në parkun aty pranë. Të gjithë nxënësit janë të mirëpritur të marrin pjesë.

Aktiviteti 2

Çfarë ka në mbeturinat tona?
Përpiqu brenda një dite të shënosh me kujdes atë që hidhet në shtëpinë tënde.

Ki kujdes! Vish doreza gome kur trajton mbeturinat dhe ki kujdes për xhamat e thyer.

Do të të duhet:
qese e madhe plehrash, bllok shënimesh dhe laps, doreza gome.

Mund të bësh një pasqyrë të mbeturinave, duke numëruar sa kanaçe, shishe, letra dhe gjëra të tjera hidhen nga njerëzit. Kjo do të të ndihmojë të shohësh se sa mbeturina mund të riciklohen. Duke punuar në çifte, mblidh mbeturinat, shënoji dhe vendosi në qese. Mendon se cili do të jetë lloji më i zakonshëm i mbeturinave. Bëj një listë të të gjitha llojeve që gjen. Më pas, numëro sa artikuj të çdo lloji të mbeturinave ke mbledhur më parë. Bëj një tabelë për të regjistruar rezultatet. Paraqiti rezultatet me grafik shtyllor.

MENDO!

A përputhen provat që ke mbledhur gjatë aktivitetit me mendimet e tua?

Burimet e energjisë

Sot e marrim energji kryesisht duke djegur lëndët djegëse fosile (thëngjill, naftë dhe gaz natyror). Materiet e tilla janë **burime jo rinovuese** të energjisë dhe e ndotin shumë planetin tonë. Ekzistojnë edhe mënyra për të prodhuar energji që nuk e ndotin mjedisin jetësor. Të tilla janë **burimet rinovuese** të energjisë - burime që nuk mund të shpenzohen (dielli, era, uji dhe nxehtësia nga brendësia e tokës).



Burimet rinovuese të energjisë

MENDO!

Çfarë mund të bësh në lagjen tënde për të parandaluar hedhjen e mbeturinave?

Të gjithë mund të kujdesen për mjedisin jetësor. Shembulli më i thjeshtë do të ishte duke përdorur më pak ujë dhe energji. Ndihmon për të ruajtur secilin prej këtyre burimeve.

Uji mund të kursehet lehtësisht. Këtu janë disa ide.

Bëj dush në vend që të shtrihesh në vaskë plot me ujë. Mos e lër rubinetin të rrjedhë.

Mblidhe ujin e shiut në enë dhe përdore atë për të ujitur oborrin.

Energjia mund të kursehet lehtësisht. Këtu janë disa ide.

Fikeni llambën elektrike kur nuk e përdor. Përdor llamba me efikasitet të energjisë.

Ec më këmbë ose përdor biçikletë në vend të makinës ose autobusit.

Përdor panele diellore për të ngrohur ujin. Ato janë shumë më të lira dhe më të pastra sesa përdorimi i bojlerëve elektrikë.

PYETJE

1. Si ndotet më shpesh sipërfaqja e tokës?
2. A mund të kursehet energjia dhe uji? Jep disa shembuj.

ÇFARË KE MËSUAR

- Për të ndihmuar në kujdesin ndaj mjedisit, nuk duhet të hedhim mbeturina kudo.
- E rëndësishme është të zvogëlohet sasia e mbeturinave që krijojmë.
- Ne mund të kujdesemi për mjedisin jetësor duke kursyer ujin dhe energjinë.

3.6 NDIKIMI I NDOTJES NDAJ NJERËZVE, KAFSHËVE DHE BIMËVE

FJALË PËR TË MËSUAR:

astmë, bronkit, helmim

Shëtitja jashtë në mjedis jetësor ku ajri është i ndotur mund të jetë e rrezikshme për shëndetin tënd. Ajrin e thithim dhe me organet e sistemit të frymëmarrjes ai udhëton nëpër to dhe arrin në mushkëri. Nëse është i ndotur, grimcat që e bëjnë atë ndotje hyjnë në organizmin tonë.

Ajri i ndotur tregon efektin e tij të dëmshëm për kafshët dhe bimët në mjedisin jetësor.

Shpesh ajri i ndotur është i pranishëm në qytete. Njerëzit në viset e ndotura shpesh marrin bronkit dhe astmë, sëmundje të organeve të frymëmarrjes.

Në rast të ndotjes së ajrit te njerëzit shfaqen bronkiti dhe astma

Ndotja e ujit mund të jetë në të gjitha sistemet ujore (për shembull, liqenet, lumenjtë, oqeanet, ujërat e zeza dhe ujërat nëntokësore). Ndotja e ujit ndodh kur ndotësit lëshohen në ujë pa masa mbrojtëse.

Ndotja e ujit i prek bimët dhe organizmat që jetojnë në këto sisteme ujore. Pothuajse në të gjitha rastet, efekti është i dëmshëm jo vetëm për llojet dhe popullatat individuale, por edhe për të gjithë komunitetin jetësor.

Breshkat hanë qese plastike sepse duken si meduzë deti. Plastika qëndron në stomakun e tyre dhe ato cofin

Uji i ndotur te njerëzit shkakton kryesisht probleme shëndetësore të organeve të sistemit tretës, si helmime dhe dhimbje stomaku

AKTIVITET

Gjatë shëtitjes nëpër lagjen ku jeton, vëre se cilat bimë dhe kafshë janë në viset ku ka mbeturina ose ujë të ndotur. Ndaji rezultatet dhe përfundimet e tua me shokët e tu dhe nxirr përfundime.

Ndotja e tokës është kryesisht nga mbeturinat që hidhen në sipërfaqen e tokës ose nga uji i ndotur. Materiet nga uji i ndotur absorbohen në ujërat nëntokësore të përdorura nga bimët. E, kështu materiet e dëmshme transferohen në bimë. Dhe e dimë se bimët hahen shpesh nga kafshët dhe njerëzit. Në situatë të tillë, efektet e dëmshme të mjedisit të ndotur mund të shkaktojnë një numër të madh sëmundjesh te njerëzit.

Cili do të ishte përfundimi? A duhet ta mbrojmë dhe ta ruajmë mjedisin tonë jetësor?

PYETJE

1. Ajri i ndotur dëmton organet e frymëmarrjes. Pse?
2. A mund t'i dëmtojë kafshët uji i ndotur i përdorur nga bimët me rrënjët e tyre? Shpjego përgjigjen.

ÇFARË KE MËSUAR

- Në rast të ndotjes së ajrit rrezikohen si bimët ashtu edhe kafshët.
- Bronkiti dhe astma shfaqen te njerëzit për shkak të ndotjes së ajrit.
- Kur uji dhe toka janë të ndotura, ka sëmundje të organeve të tretjes.
- Kjo është arsyeja pse ne duhet të ndihmojmë në mbrojtjen e mjedisit në çdo mënyrë të mundshme.

3.7 LIDHJET NDËRMJET ORGANIZMAVE TË GJALLË DHE MJEDISIT JETËSOR

FJALË PËR TË MËSUAR:

ekologji, organizma të gjallë, mjedis jetësor

Lidhja midis organizmave të gjallë dhe mjedisit mund të shihet kudo rreth nesh. Shkenca që studion marrëdhëniet e ndërsjella të organizmave të gjallë dhe mjedisin e tyre jetësor quhet **ekologji**.

AKTIVITETI 1

Përshkruaj ndonjë vendbanim lokal

Viziton ndonjë vendbanim aty pranë, për shembull kopsht.

Numëroji të gjitha bimët dhe kafshët që i sheh.

Shiko nën gjethet e shkurreve dhe nën gjethet e vdekura në tokë për të gjetur insekte.

Shiko kah qielli dhe pemët për të parë shpezë.

Vëzhgoji marrëdhëniet ushqyese midis bimëve dhe kafshëve.

Diskuto për mënyra të tjera se si bimët dhe kafshët varen nga njëra-tjetra në atë vendbanim.

Pyetje:

1. Numëro tri bimë dhe tri kafshë nga vendbanimi i zgjedhur.
2. Vizato tri lidhje që i lidhin bimët dhe kafshët në kopsht.
3. Në cilat mënyra të tjera bimët dhe kafshët varen nga njëra-tjetra në vendbanim?

Mbijetesa e organizmave të gjallë është e lidhur ngushtë me ndryshimet në mjedisin jetësor. Për shembull, të gjitha kafshët marrin frymë dhe përdorin oksigjen nga mjedisi, kurse lëshojnë dioksid karboni në të.

Ekziston lidhje e kafshëve të të njëjtit lloj me mjedisin jetësor. I tillë është rasti me milingonat, nga të cilat në një komunitet secili grup është përgjegjës për kryerjen e detyrave të caktuara.

Kolonia e milingonave

Zinxhirët ushqimorë

Lidhja midis kafshëve dhe bimëve në mjedisin jetësor është shumë e madhe. Thënë thjesht, bimët prodhojnë ushqimin që e përdorin kafshët.

Kafshët e ndryshme që hanë bimë si ushqim

Ekzistojnë marrëdhënie ushqyese midis disa kafshëve dhe bimëve. Për shembull, disa vemje ushqehen me gjethe spinaqi dhe ka disa që bëjnë vrima në kërcell misri. Disa shpezë dhe hardhuca ushqehen me vemje.

Marrëdhëniet e të ushqyerit në mjedisin jetësor mund ta përshkruajmë duke përdorur **zinxhirin ushqimor**.

Zinxhiri ushqimor përshkruan marrëdhëniet ushqyese midis bimëve dhe kafshëve.

Ja një zinxhir ushqimor:

spinaq → vemje → shpezë

Shigjeta do të thotë "është ngrënë nga". Pra, ky zinxhir ushqimor na tregon se spinaqin e hëngri vemja, kurse vemjen e hëngri shpeza.

AKTIVITETI 2

Bëj një zinxhir ushqimor
Vizito ndonjë livadh aty pranë. Livadhi është vendbanim i shumë llojeve të barërave. Në livadh kullot një tufë delesh. Bëje zinxhirin ushqimor.

MENDO!

Çfarë do të hanin njerëzit dhe kafshët nëse nuk do të ekzistonin bimët?

PYETJE

1. Çfarë është ekologjia?

2. Vizato dy zinxhirë ushqimorë që përfshijnë bimë dhe kafshë.

ÇFARË KE MËSUAR

- Vendbanimi është banesë për bimët dhe kafshët në mjedisin jetësor.
- Ekologjia studion marrëdhëniet ndërmjet organizmave të gjallë dhe mjedisit jetësor.
- Zinxhirët ushqimorë i përshkruajnë marrëdhëniet ushqyese midis bimëve dhe kafshëve.

KONTROLLO SA KE MËSUAR

1. Cilat vendbanime janë treguar në figura? Numëroji disa kafshë dhe bimë që jetojnë në secilën prej tyre.

2. A mund të përshtaten bimët edhe me mjedisin e jashtëm? Jep disa shembuj?

3. Kopjoji thëniet e mëposhtme në fletore dhe plotësoji vendet e zbrazëta për ta bërë thënien e saktë.

- Përshtatja me mjedisin ku jetojnë kafshët quhet?
- _____ është ndryshim në ngjyrën e trupit të kafshëve që i ndihmon ato të fshihen nga grabitqarët ose të gjejnë ushqim.
- _____ dhe _____ përfaqësojnë mënyrë të "fjetjes" përmes kushteve të pafavorshme në banesë.
- _____ janë shpërngulje të kafshëve në kërkim të ushqimit, vendbanimit dhe kushteve të favorshme të jetesës.
- Lidhja ndërmjet organizmave të gjallë që jetojnë më gjatë në të njëjtin mjedis quhet _____.
- _____ është kafshë që ushqehet me kafshë të tjera.
- _____ është kafsha me të cilën ushqehet grabitqari.

4. Jep disa shembuj të kafshëve që migrojnë. Shpjego arsyen e migrimit të tyre.

5. Përshkruaj se si disa sende pranë jush mund të riciklohen ose ripërdoren.

6. Në fletore lidhi numrat me shkronjat sipas kuptimit të tyre.

a) Gjumi i dimrit	1) Kafshët e shkretëtirës
b) Migrimi	2) Ariu
c) Estivim	3) Insekt dhe lule
d) Simbiozë	4) Gëlltitje

7. Numëroji parqet kombëtare në vendin tonë dhe përshkruaj të paktën një karakteristikë.

8. Tregoje renditjen e saktë të organizmave të gjallë në këto zinxhirë ushqimorë.

a) plankton → pulëbardhë → peshk

c) insekt → hardhucë → fara → skifter

ç) peshkaqen → plankton → peshk i vogël → fokë

TEMA 4: PËRZIERJET

REZULTATET NGA MËSIMI:

Nxënësi/nxënësja do të jetë në gjendje:

1. Të përshkruajë përzierjet e ndryshme, të numërojë përbërësit e tyre dhe të shpjegojë ndryshimin midis përzierjeve homogjene dhe heterogjene;
2. Të dallojë tretës, substancë të tretur dhe tretësirë dhe të shpjegojë ndikimin e temperaturës, përzierjes dhe madhësisë së grimcave të substancës së tretur në tretjen e substancave të ngurta në ujë;
3. Të përshkruajë procedurat për ndarjen e përbërësve nga përzierjet, të zgjedhë dhe të zbatojë procedurën/procedurat e duhura dhe pajisjen e përshtatshme laboratorike për ndarjen e përbërësve nga përzierja e caktuar.

4.1 PËRBËRJA E PËRZIERJEVE

FJALË PËR TË MËSUAR:

substancë, përzierje, përbërës të përzierjes

Kur prindi yt vjen nga tregu në shtëpi, ndër produktet e blera gjenden një litër vaj, një kilogram sheqer, një kilogram kripë, një litër e gjysmë ujë, një kilogram patate. Pra, produktet e blera mund të kenë vëllim të caktuar (një litër, etj.) ose masë të caktuar (një kilogram, etj.). Ato gjenden rreth teje, që do të thotë se ato janë **materie**!

Qeset me produkte nga tregu



Edhe drita është materie!

Në mbrëmje, në errësirë, kur e shtyp butonin e ndërprerësit, drita e llambës e mbush rrethinën. Edhe ajo është rreth teje!

Edhe drita është materie! Por drita nuk është substancë!

Çfarë është substanca?

Substanca është një nga format e materies që ka masë dhe zë vëllim.

E gjithë natyra e gjallë dhe jo e gjallë është ndërtuar nga substanca!
Substancat në natyrë zakonisht gjenden në formën e përzierjeve.

Mineralet janë përzierje

Uji i detit është përzierje

Përzierjet janë një lloj lënde që përbëhen nga dy ose më shumë substanca të tjera të përziera së bashku pa ndryshuar identitetin e tyre.

Substancat që përbëjnë përzierjen quhen përbërës të përzierjes.

Në jetën e përditshme has në një numër të madh shembujsh përzierjesh.

Përzierjet mund të përbëhen nga përbërës në të njëjtën gjendje agregate.



Erëzat e përziera janë përzierje e ngurtë e përbërësve në gjendje të ngurtë agregate: kripë, perime të thata, përmirësues shije, etj.

Uthulla është përzierje e lëngshme e përbërë nga përbërës në gjendje të lëngshme: ujë dhe acid acetik

Ajri që del nga pastrues ajri është përzierje e gaztë që është kryesisht pa pluhur dhe përbëhet kryesisht nga përbërës në gjendje të gaztë: azoti dhe oksigjeni, etj.

Përzierjet mund të përbëhen gjithashtu nga çdo kombinim i ndryshëm i përbërësve në gjendje të ndryshme agregate.

Bureku është përzierje e përbërë nga përbërës të lëngshëm, ujë, vaj gatimi dhe përbërës të ngurtë, miell, kripë etj.

Uji mineral është përzierje e lëngshme e përbërë nga përbërës i lëngshëm, uji dhe përbërës i gaztë, dioksidi i karbonit, etj.

AKTIVITETI 1

Do të të duhet:
tri gota tejdukshme, dy fletë letre, tri lugë plastike, kafe, sheqer, erëza të përziera, vaj, kripë dhe ujë.

Në gotë hidh nga një lugë kafeje dhe sheqer. I përzien me lugë. Vendose përzierjen në letër dhe kontrollo me kujdes masën e përgatitur. A mund të shikosh kristale sheqeri në të?

Hidh një lugë çaji me erëza të përziera në fletë letre! Si duket erëza?

Shtoi gjysmën e gotës ujë dhe një gjysmë lugë të vogël kripë. Përzieje me lugë derisa ta shikosh kripën. Si duket kjo përzierje?

Hidhe gjysmën e ujit dhe pak vaj në gotë tjetër! Përzieje me kujdes vajin dhe ujin me një lugë. Si duket kjo përzierje? A është tretur vaji në ujë?

AKTIVITETI 2

Do të të duhet:
fletë e pastër letre, dy lugë çaji, thërrime buke, sheqer.

Përzierjet kanë përbërje të ndryshueshme dhe veti të ndryshueshme

Duke përzier një lugë çaji me grimca buke dhe një lugë çaji me sheqer në fletë të pastër letre, përgatit përzierje të këtyre materieve.

Provoje shijen. A është përzierja e butë?

Hidh një lugë tjetër sheqer në përzierje dhe përzieje. Shijoje përzierjen. A ka shije më të ëmbël përzierja?

Nga shija e përzierjes mund të përfundosh se sheqeri e ka ruajtur shijen e tij të ëmbël. Përbërësit në përzierje i ruajnë vetitë e tyre!

Duke shtuar përbërës në përzierje, vetitë e saj mund të ndryshohen. Prandaj, përzierjet kanë përbërje të ndryshueshme dhe veti të ndryshueshme.

Ato varen nga vetitë dhe sasia e shtuar e përbërësve që i përbëjnë përzierjet.

MENDO!

Nëse vendose dy lugë çaji me sheqer në ujë dhe i përzieni, do të mund ta dallosh sheqerin në fillim. Por pas një kohe sheqeri do të tretet dhe nuk do të jetë më i dukshëm.

Çfarë është përzierja në këtë rast?

a) Uji dhe sheqeri, në fillim, derisa sheqeri të tretet.

b) Lëngun e ujit dhe sheqerit të tretur.

c) Në të dyja rastet ka përzierje.

Pse drita nuk është substancë?

PYETJE

1. Çfarë është substanca?
2. A është e saktë të thuhet se materia është substancë?
3. A ka materie që nuk është substancë?
4. Çfarë është përzierja?

ÇFARË KE MËSUAR

- Substanca është një nga format e materies që ka masë dhe zë vëllim.
- Përzierjet përbëhen nga dy ose më shumë substanca të përziera së bashku pa ndryshuar identitetin e tyre.

4.2 LLOJET E PËRZIERJEVE

FJALË PËR TË MËSUAR:

përzierje homogjene, përzierje heterogjene

Përzierjet fitohen nga përzierja e dy ose më shumë substancave. Nëse në përzierje mund të vërehen substanca nga të cilat është përgatitur, d.m.th. përbërësit e përzierjes, atëherë përzierjen e tillë e quajmë **përzierje heterogjene**. Materiet e veçanta mund të shihen me sy të lirë, xham zmadhues ose mikroskop. Në fakt, ato janë pjesë homogjene në përzierje heterogjene dhe ndahen nga njëra-tjetra me sipërfaqe kufitare.

Graniti është përzierje natyrale heterogjene

Për shembull, në natyrë ekziston shkëmb i quajtur granit. Graniti përdoret për të prodhuar pllaka që më pas mund të përdoren për të shtruar dyshemetë ose sipërfaqe të tjera. Graniti u formua nga ftohja e llavës vullkanike. Mund të shihet me sy të lirë se është përzierje heterogjene. Ai përmban minerale siç janë kuarci, liskuni e të tjerë.

Shembuj tipikë të përzierjeve heterogjene janë erëzat e përziera, lëngjet e trasha, qumështi, lloje të ndryshme barnash në formë tabletash, detergjentë të ngurtë lavanderie etj.

Përzierjet homogjene janë përzierje në të cilat substancat nga të cilat përbëhen nuk mund të vëzhgohen me sy të lirë, zmadhues ose mikroskop. Nuk ka vise kufitare me ta. Në pamje, ato janë të barabarta në të gjithë vëllimin.

Mesingu është legurë, d.m.th., përzierje homogjene e metaleve të zinkut dhe bakrit. Shembuj të tjerë të përzierjeve homogjene janë uthulla, tretësira ujore e kripës ose sheqeri, ari i verdhë që përdoret për bizhuteri është përzierje e arit dhe argjendit, etj.

Disa instrumente muzikore, frymore janë bërë prej bronzi

Mbaj mend! Duke përzier dy ose më shumë substanca të ngurta, sado të përpiqesh t'i përziesh, nuk mund të marrësh përzierje homogjene!

Në disa raste ajo që në shikim të parë duket në sy si përzierje homogjene, pas një analize të kujdesshme mund të jetë përzierje heterogjene.

Një rast i tillë mund të jetë rëra, e cila në pamje të parë duket si përzierje homogjene, por në fakt është përzierje heterogjene. Gjaku gjithashtu mund të japë përshtypjen se është përzierje homogjene, por ai është përzierje heterogjene.



Rëra me zmadhim 400 herë

Rëra nuk është përzierje homogjene

AKTIVITET

Përzierje homogjene dhe heterogjene

Në dy filxhanë vendose një lugë të vogël të secilës prej dy substancave. Për shembull, në gotë vendos sheqer dhe rërë. Në tjetrën ujë dhe kripë etj. Përzieji substancat në gota me një lugë çaji. Përgatit të paktën pesë përzierje. Le të ketë të paktën dy përzierje homogjene në to. Shiko përzierjet me xham zmadhues. Mundohu t'i përshkruash dhe përcaktosh qofshin ato homogjene apo heterogjene.

Do të të duhet:
zmadhues, kakao, sheqer, kripë, miell, rërë, shkumës i grimcuar, ujë dhe vaj, shtatë lugë plastike, pesë gota të tejdukshme, gërshërë, fletë letre.

MENDO!

Çfarë lloj përzierjeje do të fitosh duke përzier përzierje homogjene dhe përzierje heterogjene? Për shembull, nëse përzien qumështin dhe ujin e detit.

Çfarë përzierje do të fitosh nëse shpërndan një lugë çaji me sheqer në çaj të pastër?

PYETJE

1. Çfarë përzierje janë ajri dhe uji i pastër i detit?
2. Cili është ndryshimi midis përzierjeje heterogjene dhe përzierjes homogjene?

ÇFARË KE MËSUAR

- **Përzierja heterogjene** është përzierja në të cilën mund të vërehen substancat nga të cilat përbëhet, d.m.th. përbërësit e përzierjes.
- **Përzierjet homogjene** janë përzierje në të cilat substancat nga të cilat përbëhen nuk mund të vërehen me sy të lirë, me zmadhues ose me mikroskop.

4.3 TRETJET DHE SHPËRBËRJA

FJALË PËR TË MËSUAR:

tretësirë, tretës, lëndë e tretur, shpërbërje

Nëse në gotë laboratori hidh ujë dhe një lugë çaji me sheqer në gjysmë të rrugës dhe më pas i përzieni me shufrën e qelqit, do të shikosh që sheqeri zhduket, domethënë tretet në ujë.

Gjatë tretjes së sheqerit, grimcat e tij ndërtuese shpërndahen ndërmjet grimcave të tretësit.

Substancat që treten si sheqeri quhen **substanca të tretura**. Uji përfaqëson **tretës**, kurse lëngu që rezulton pas tretjes quhet **tretësirë**.

A mund ta shihni sheqerin e shtuar në tretësirën e përgatitur kështu?

Sheqeri i tretur nuk shihet as me mikroskop!



Gota e laboratorit dhe thupra e qelqit përdoren gjatë përgatitjes së tretësirave



Ilustrim i tretjes së sheqerit në ujë. Grimcat ndërtuese të sheqerit nuk janë toptha, edhe pse në figura janë treguar të tilla

Tretësirat janë përzierje homogjene!

Disa substanca janë të tretshme dhe disa janë të patretshme në ujë!

Në tretës të caktuar, sasi e kufizuar dhe e përcaktuar saktësisht e substancës së ngurtë të tretur mund të shpërndahet në temperaturë të caktuar.

*Tretësirat të cilat në temperaturë të caktuar mund të treten edhe nga substanca e tretur quhen **tretësirë të pangopura***

*Tretësira në të cilën është tretur sasia maksimale e substancës së tretur, në temperaturë të caktuar, quhet **tretësirë e ngopur**.*

Tretësira e tejngopur është tretësirë që në temperaturë të caktuar përmban sasi më të madhe të substancës së tretur se sa tretësira e ngopur. Këto tretje mund të merren vetëm në kushte të caktuara, për shembull, duke ftohur një tretje të ngopur të nxehtë. Ato janë të paqëndrueshme dhe mund të shkaktojnë lehtësisht ndarjen e teprice të substancës së tretur në krahasim me tretësirën e ngopur në atë temperaturë.

AKTIVITET

Testi i tretshmërisë

Në gotën e parë hidh ujë deri në gjysmën e vëllimit të tij. Shto një lugë çaji me sheqer në të. Përzieje me lugë dhe vëzhgoji ndryshimet. Çfarë vëren?
Shëno në fletore nëse sheqeri tretet apo jo në ujë.

Do të të duhet:
pesë gota të tejdukshme, pesë lugë plastike, kripë, vaj, sheqer, shkumës të grimcuar, uthull dhe ujë.

Përsërite provën me substancat e tjera dhe shënoji në fletore nëse kripa, vaji, sheqeri, shkumësi dhe uthulla janë të tretshme apo të patretshme në ujë.

Tretshmëria varet edhe nga temperatura. Kjo do të thotë se nëse ngrohim tretësirë të ngopur me sheqer të tepërt në fund të gotës dhe e përziejmë, sheqeri do të tretet. Kjo tretësirë në temperaturë më të lartë do të jetë në gjendje të shpërndajë më shumë sheqer, që do të thotë se është tretësirë e pangopur.

Për shumicën e substancave të ngurta, tretshmëria rritet me rritjen e temperaturës.

MENDO!

Çfarë duhet të bësh nëse në një vëllim të caktuar të tretësirës së ngopur nga substanca e ngurtë në temperaturën e dhomës duhet të tretësh më shumë nga substanca?

Çfarë pret të ndodhë nëse ftoh tretësirë të ngopur të ngrohur në temperaturën e dhomës?

PYETJE

1. Si quhet substanca, grimcat ndërtuese të së cilës shpërndahen ndërmjet grimcave të tretësit?
2. Çfarë lloj përzierjesh janë tretësirat?
3. A mundet vëllim i caktuar uji të tretë sasi të pafundme sheqeri?

ÇFARË KE MËSUAR

- Te substancat e ngurta tretshmëria zakonisht rritet me rritjen e temperaturës.
- **Tretësirat e pangopura** janë tretësirat që mund të treten edhe nga substanca e tretur në temperaturë të caktuar.
- **Tretësira e ngopur** është tretësira në të cilën është tretur sasia maksimale e substanca së tretur, në temperaturë të caktuar.
- **Tretësirë e tejngopur** është tretësirë që në temperaturë të caktuar përmban sasi më të madhe të substancës së tretur sesa tretësira e ngopur.

4.4 FAKTORËT THEMELORË TË CILËT NDIKOJNË NË TRETJEN E SUBSTANCAVE TË NGURTA NË UJË

Ndikimi i temperaturës në tretjen e substancave të ngurta në ujë

Ngrohja, pra rritja e temperaturës, zakonisht shkakton tretje më të shpejtë të substancave të ngurta të tretshme në ujë.

Rritja e temperaturës së ujit bën që grimcat e ujit të lëvizin më shpejt dhe grimcat e sheqerit të dridhen më shumë

AKTIVITETI 1

Hulumtimi i ndikimit të temperaturës në tretjen e sheqerit në ujë

Do të të duhet:
tri gota tejdukshme, dy lugë plastike, tretësirë, gotë e vogël, shiringë 20 ml, sheqer dhe ujë.

Hidh 6 lugë të plota me sheqer në dy gota. Niveli i sheqerit në gota duhet të jetë i barabartë. Në filxhan të tretë hidh 20 ml ujë me shiringë. Duhet të jetë në temperaturën e dhomës. Hidh 20 ml ujë në tenxhere dhe angazhoje prindin tënd ta ngrohë derisa të vlojë. Pasi uji të vlojë, nuk duhet lejuar të vazhdojë zierja. Derdhe ujin nga gota në gotën me sheqer dhe në të njëjtën kohë angazhoje prindin tënd të hedhë ujin e nxehtë në gotën tjetër me sheqer. Përzieje së bashku dhe shiko se në cilën gotë sheqeri do të tretet më shpejt.

A ka ndonjë ndryshim në shpërbërjen me ujin e nxehtë dhe të pa ngrohur?

Në cilën gotë sheqeri u tret më shpejt?

Ndikimi i përzierjes së tretësirës mbi tretjen e substancave të ngurta në ujë

Gjatë përzierjes grimcat ndërtuese të tretësit lëvizin dhe lejohen të vijnë në kontakt me substancën e ngurtë të patretur si dhe të largojnë substancën e tretur nga sipërfaqja e substancës së patretur. Në këtë mënyrë përzierja përshpejton shpërndarjen e grimcave ndërtuese të substancës së ngurtë ndërmjet grimcave të tretësit.

Përzierja e shkurton kohën e tretjes, por nuk ndikon në sasinë e masës së ngurtë që do të tretet në ujë.

Tretja e substancave, përveç ngrohjes, mund të përshpejtohet edhe duke aplikuar përzierjen

Përzierja është shumë e rëndësishme në kërkimin shkencor. Kjo është arsyeja pse përdoren pajisjet elektrike për përzierjen

AKTIVITET 2

Ekzaminimi i ndikimit të përzierjes ndaj tretshmërisë

Do të të duhet:
dy gota tejdukshme, një lugë plastike, sheqer dhe ujë.

Mbushi dyja gotat përgjysmë me ujë. Vëllimi i ujit duhet të jetë i barabartë në të dy gotat.

Më pas vendosi njërën pranë tjetrës.

Në të dyja gotat hidh dy lugë çaji me sheqer po aq të plota.

Me lugën e çajit përzieje përmbajtjen vetëm në gotë.

Në cilën gotë sheqeri tretet më shpejt?

Ndikimi i madhësisë së grimcave ose copave ndaj shpërbërjes së substancave të ngurta në ujë

Sheqeri është substancë e ngurtë e bardhë. Në shtëpinë tënde, në kuzhinë, mund ta gjesh në tri forma.

Sheqeri mund të gjendet në forma të ndryshme. Copat homogjene të substancës së ngurtë me formë të rregullt gjeometrike quhen kristale

Nuk është gjë e njëjtë, në lidhje me kohën e tretjes, a do të tretësh në ujë sheqer pluhuri ose kristale të mëdha!

Kokrra e sheqerit përbëhen nga grimca të vogla të ngjitura së bashku - kristale sheqeri

AKTIVITET 3

Ekzaminimi i ndikimit të madhësisë së grimcave ose pjesëve të substancës në tretjen në ujë

Do të të duhet: peshore kuzhine, tri gota tejdukshme, tri lugë plastike, ujë, sheqer në tri forma: pluhur, kristale dhe kube.

Kryeje këtë aktivitet me ndihmën e shokut tënd.

Në tri gota vendos vëllim të barabartë uji (deri në gj
peshore, peshoje masën e të dy kokrrave sheqeri. M
letre, matni veçmas të njëjtën sasi sheqeri pluhur dhe sheqeri të grimcuar (ashtu siç blihet në dyqan).

Në secilën prej gotave veç e veç, me shokun tënd, vendose sheqerin në të njëjtën kohë. Në një gotë kokërr, në tjetrën sheqerin pluhur dhe në të tretën sheqerin e mbetur. Me nga një lugë çaji në secilin filxhan, përziej në mënyrë të barabartë në të gjitha gotat dhe shiko se në cilin filxhan do të tretet më shpejt.

MENDO!

A e rrit përzierja tretshmërinë e substancave të ngurta apo thjesht i bën ato të treten më shpejt?

Tretshmëria a është më e madhe me sheqer pluhur apo sheqer të grirë në kubë apo thjesht tretet më shpejt nëse sheqeri pluhur tretet?

Imtësimi dhe pluhurimi i substancave të ngurta a do të mundësojnë tretjen e tyre?

PYETJE

1. Pse aplikohet përzierja gjatë përgatitjes së tretësirës?
2. Imtësimi dhe pluhurimi i substancave të ngurta a do të mundësojnë tretje më të shpejtë?
3. A ndihmon më shpesh ngrohja në tretjen më të shpejtë të substancave të ngurta të tretshme?
4. Çfarë duhet aplikuar njëkohësisht për tretjen më të shpejtë të substancave të ngurta të tretshme?

ÇFARË KE MËSUAR

- Ngrohja, përzierja dhe përdorimi i lënde në formë pluhuri lejon tretjen më të shpejtë të materieve të tretshme të ngurta.
- Përzierja gjatë tretjes nuk lejon tretjen e sasie më të madhe të materieve të tretshme të ngurta, por vetëm tretje më të shpejtë.

4.5 NDARJA E PËRBËRËSVE NGA PËRZIERJA: SITJA DHE DEKANTIMI

FJALË PËR TË MËSUAR:

sitje, dekantim

Kur përzihen në përzierje, substancat e ruajnë identitetin e tyre, d.m.th. ato nuk ndryshojnë kimikisht. Do të thotë gjithashtu se substancat në përzierje nuk janë të lidhura kimikisht me njëra-tjetrën! Kjo na lejon t'i ndajmë përbërësit individualë nga përzierjet.



Ndarja e rërës nga zhavorri me sitje

Procesi i **sitjes** normalisht nuk përdoret për të ndarë substanca të ndryshme, por kryesisht për të ndarë përbërës të dimensioneve të ndryshme nga e njëjta substancë.

Aplikimi i sitjes për të ndarë gurët nga toka e dobishme

Për shembull, kopshtarët i ndajnë gurët nga toka pjellore me sitje. Në ndërtimtari rëra me granulime të ndryshme ndahet për qëllime të ndryshme.

Në amvisëri sita përdoret për sitjen e miellit

Për sitje shpesh përdoren sita me madhësi të ndryshme rrjetore

Procedura më e thjeshtë e ndarjes është dekantimi. Përzierjet heterogjene zakonisht nuk janë të qëndrueshme. Për shembull, nëse vendos rërë në gotë me ujë dhe e përzieni, pas një kohe të caktuar rëra do të vendoset në fund të gotës. Përzierja/kullimi i kujdesshëm i lëngut (ujit) në gotë tjetër lejon ndarje të përafërt të ujit nga rëra. E përafërt, sepse një pjesë e ujit mbetet me rërë. Kjo ndarje e lëngut nga substanca e ngurtë e shtresuar, me ndarje të kujdesshme, quhet **dekantim**.

Fotografia e procedurës së dekantimit

AKTIVITET

Do të të duhet:
kripë, ujë, filxhan, lugë çaji, kapak kavanozi.

Dekantimi dhe ndarja e substancës së tretur nga

Hidh dy lugë kripë në gotë. Më pas shtoi 4 lugë ujë dhe përzieje për disa minuta. Ndalu me përzierje dhe lëre kripën të ulet deri në fund të gotës. Më pas derdhe (dekantoje) me kujdes pjesën e vogël të lëngut në kapak kavanozi. Kapakun lëre gjatë natës në vend të sigurt.

Të nesërmen shiko se çfarë ndodhi me tretësirën në kapakun e kavanozit.

Çfarë vëren, çfarë ka në kapak?

MENDO!

Gjatë mbledhjes së frutave të bredhit blu, mblidhen edhe një pjesë e gjetheve të gjilpërës.

Nëse ke përzierje kokrrash, fruta të dëllinjës dhe gjilpëra, cilat duhet të jenë hapjet e sitës në mënyrë që gjilpërat të kalojnë nëpër të gjethet, kurse frutat e dëllinjës të mbeten në sitë?

Hapjet e sitës duhet të jenë vetëm të rrumbullakëta apo katrore?

PYETJE

1. Cilat përzierje mund të ndahen në përbërësit e tyre me dekantim?
2. A përdoret sitja në shtëpinë tënde dhe për çfarë qëllimi?

ÇFARË KE MËSUAR

- **Sitja** përdoret zakonisht për të ndarë përbërësit e përzierjes me madhësi të ndryshme grimcash/copësh.
- Për sitje përdoren shpesh sita me madhësi të ndryshme të vrimave.
- **Dekantimi** është ndarja e lëngut nga substanca e ngurtë e shtresuar, duke dekantuar me kujdes.

4.6. NDARJA E PËRBËRËSVE NGA PËRZIERJA: FILTRIMI, KRISTALIZIMI DHE NDARJA MAGNETIKE

FJALË PËR TË MËSUAR:

filtrimi, avullimi, kristalizimi dhe ndarja magnetike

Filtrimi lejon ndarjen e **substancës së ngurtë të patretshme** nga **tretësi** ose tretësira e lëngshme.

Filtri përmban vrima të vogla nëpër të cilat mund të kalojnë grimcat e vogla të tretësit ose tretësirës, kurse ato më të mëdha që u përkasin substancës së patretur (të cilës i detyrohet turbullira) i mban ato në sipërfaqen e saj. Në këtë mënyrë filtri në të vërtetë vepron si sitë në procesin e sitjes.

Filtri më shpesh është letër filtri.

Filtrimi përdoret për të përgatitur kafe filtri

Në amvisëri letër të tillë mund të përdoret nga prindërit për të përgatitur kafe filtri.

Çajrat paketohen në qese filtri në familje

Filtrimi kryhet me pajisje siç tregohet në figurë. Gjatë filtrimit përzierja heterogjene transferohet me kujdes në letrën filtruese në hinkë. Lëngu që kalon nëpër letër filtri quhet **filtrat**. Substanca e ngurtë e patretshme quhet **fundërrinë (precipitat)**.



Paraqitja grafike e filtrimit

Letra filtruese nuk mund të ndajë sheqerin ose kripën e tretur nga tretësirat ujore. Dimensionet e grimcave ndërtuese të këtyre materieve të tretura janë më të vogla se hapjet e letrës së filtrit, kështu që ato mund të kalojnë nëpër të pa problem.

AKTIVITET

Do të të duhet:
varg, pëlhurë, rërë, guralecë ose zhavorr, shishe plastike, lugë plastike, humus.

Ndarja e përbërësve nga përzierjet
Pastrimi i ujit

Filtrimi i rërës mund të pastrojë ujin.

